



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE

Raporti vjetor i punës për vitin 2018

drejtuar

Kuvendit të Republikës së Kosovës

Mars 2019

TABELA E PËRMBAJTJES

PËRMbledhje EKZEKUTIVE	7
KORNIZA LIGJORE	8
PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT	8
<i>Misioni i KPM-së është:</i>	8
ORGANIZIMI INSTITUCIONAL.....	8
<i>Përbërja dhe mandati i anëtarëve të KPM-së</i>	8
<i>Përbërja e KPM-së gjatë vitit 2018</i>	9
<i>Nominimet dhe emërimet e anëtarëve të KPM-së gjatë vitit 2018</i>	9
<i>Emërimi i anëtarit të tretë të Bordit për Ankesa</i>	10
AKTIVITETET E KPM-së.....	11
<i>Mbledhja e parë e KPM-së, e mbajtur më 30 janar 2018</i>	11
<i>Mbledhja e dytë e KPM-së, e mbajtur më 26 shkurt 2018</i>	11
<i>Mbledhja e tretë e KPM-së, e mbajtur më 12 mars 2018</i>	11
<i>Mbledhja e katërt e KPM-së, e mbajtur më 15 mars 2018</i>	11
<i>Mbledhja e pestë e KPM-së, e mbajtur më 22 qershor 2018</i>	12
<i>Mbledhja e gjashtë e KPM-së, e mbajtur më 4 korrik 2018</i>	12
<i>Mbledhja e shtatë e KPM-së, e mbajtur më 1 gusht 2018</i>	14
<i>Mbledhja e tetë e KPM-së, e mbajtur më 6 shtator 2018</i>	14
<i>Mbledhja e nëntë e KPM-së, e mbajtur më 18 shtator 2018</i>	15
<i>Mbledhja e dhjetë e KPM-së, e mbajtur më 26 tetor 2018</i>	15
<i>Mbledhja e njëmbëdhjetë e KPM-së, e mbajtur më 6 dhjetor 2018</i>	16
<i>Mbledhja e dymbëdhjetë e KPM-së, e mbajtur më 21 dhjetor 2018</i>	16
VAZHDIMI I PUNËS NË HARTIMIN DHE AMANDAMENTIMIN E AKTEVE NËNLIGJORE	18
<i>Konsultimet publike lidhur me aktet nënligjore të KPM-së</i>	18
RAPORTIMI I KPM-së NË TAKIMET E DIALOGUT TË PROCESIT TË STABILIZIM ASOCIIMIT	18
ORGANIZIMI I TAKIMEVE REGJIONALE ME MEDIA.....	19
PUBLIKIMET LIDHUR ME SKEMAT PROGRAMORE DHE PAJTUESHMËRINË E OSHMA-VE ME AKTET NËNLIGJORE.....	19

BASHKËPUNIMI ME ORGANIZATA VENDORE DHE NDËRKOMBËTARE	21
<i>Bashkëpunimi në kuadër të platformës evropiane të autoriteteve rregullatore (EPRA)</i>	21
<i>Bashkëpunimi në kuadër të Rrjetit Mediteran të Autoriteteve Rregullatore (MNRA)</i>	22
<i>Konferenca regjionale e autoriteteve rregullative të medie, në kuadër të projektit të Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian “JUFREX”</i>	22
ORGANIZIMI I PUNËTORISË NË BASHKËPUNIM ME KOMISIONIN PARLAMENTAR PËR MEDIA LIDHUR ME NDRYSHIMIN E LIGJIT PËR KPM-në	23
PUNA E ZYRËS EKZEKUTIVE	23
<i>Burimet njerëzore</i>	24
DEPARTAMENTI I MONITORIMIT DHE ANALIZËS (DMA)	24
<i>Pajtueshmëria me Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës së KPM-së - Pjesa 3 e Licencës</i>	24
<i>Pajtueshmëria me Rregulloren KPM 2013/01 për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-vizuele</i>	25
<i>Pajtueshmëria me Rregulloren KPM 2017/07 për Komunikimet Komerciale Audio-Vizuele</i>	26
<i>Pajtueshmëria me Rregulloren KPM 2013/02 për të Drejtën e Autorit</i>	26
<i>Pajtueshmëria me Rregulloren për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale dhe Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës së KPM-së për Distribuimin Kabllor të Programeve Radio Televizive në Kosovë</i>	27
<i>Ankesat e Parashtruara dhe rastet Ex officio</i>	27
<i>Vizitat/ Inspektimet</i>	28
DEPARTAMENTI I LICENCIMIT	28
<i>Numri i përgjithshëm i të licencuarve në Republikën e Kosovës</i>	28
<i>Numri i TV dhe Radio stacioneve të licencuara sipas gjuhëve:</i>	28
<i>Numri i Operatorëve të Shpërndarjes (OSH)të licencuar:</i>	29
<i>Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale (OSHMA) të cilët transmetojnë përmes Operatorëve të Shpërndarjes</i>	29
<i>Shqyrtimi i kërkesave</i>	29
<i>Rastet të cilat janë mbyllur pa pasur nevojë për vendim të Komisionit, gjithsej 1:</i>	30
<i>Rastet që janë bartur për shqyrtim në vitin 2019, janë gjithsej 12 raste:</i>	30

DEPARTAMENTI LIGJOR.....	30
<i>Rastet për transmetim ilegal-Shkelja e nenit 21, paragrafi 1 dhe nenit 30 paragrafi 5 e Ligjit 04/L-44 të KPM-së</i>	<i>30</i>
<i>Rastet e Shkeljes së Ligjit Nr. 04/L-44 të KPM-së, nenit 28 - Mos sjellja e Raportit vjetor</i>	<i>30</i>
<i>Rastet për shkelje të Rregullores KPM-2017/07 për Komunikime Komerciale Audiovizuale.....</i>	<i>31</i>
<i>Rastet për shkelje të Rregullores KPM-2013/01 për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-Vizuele</i>	<i>31</i>
<i>Rastet për shkeljen e Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës</i>	<i>31</i>
<i>Rastet për shkeljen e Rregullores KPM-2017/06 për Tarifën Vjetore për Licencë - Mos pagesa e tarifës për licencë.....</i>	<i>32</i>
<i>Rastet për shkeljen e Rregullores KPM-2016/01 për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale.....</i>	<i>32</i>
<i>Rastet për shkeljen e Rregullores KPM-2017/02 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale</i>	<i>32</i>
<i>Rastet për shkeljen e Rregullores KPM-2013/02 për të Drejtën e Autorit.....</i>	<i>33</i>
<i>Rastet dhe Kërkesat tjera të proceduara nga KPM gjatë vitit 2018, rastet e shkeljes së Kodit të Etikës KKPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës</i>	<i>33</i>
DEPARTAMENTI I MENAXHIMIT FREKUENCOR	37
<i>Analiza e Spektrit Frekuencor – Transmetimet analoge.....</i>	<i>37</i>
<i>Mbulueshmëria me sinjal televiziv në nivel nacional (RTK, KTV, RTV21).....</i>	<i>37</i>
<i>Mbulueshmëria me sinjal Radio FM në nivel nacional (Radio Kosova 1, Radio Kosova 2, Radio 21 dhe Radio Dukagjini)</i>	<i>38</i>
<i>Mbulimi me sinjal televiziv në nivel regional dhe lokal</i>	<i>39</i>
<i>Rastet për interferencë.....</i>	<i>39</i>
<i>Rastet për transmetime të pa licencuara</i>	<i>39</i>
<i>Frekuencat e revokuara nga KPM.....</i>	<i>39</i>
<i>Monitorime të radio frekuencave ndërkombëtare dhe bashkëpunimi me KFOR</i>	<i>40</i>
<i>Kërkesa për ndryshim të lokacionit të transmetimit</i>	<i>40</i>
<i>Raste të ndryshimit të lokacionit të transmetuesit pa miratim të KPM-së.....</i>	<i>40</i>

<i>Subjektet transmetuese të cilat kanë ndërprerë transmetimin tokësor, ose kanë zvogëluar zonën e mbulueshmërisë:</i>	40
<i>Kërkesë për frekuencë shtesë dhe frekuenca të reja:</i>	41
<i>Plani frekuencor dhe dixhitalizimi</i>	41
DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS DHE FINANCAVE	41
<i>Buxheti</i>	41
PUNA E BORDIT PËR ANKESA.....	44
<i>Përbërja e Bordit gjatë vitit 2018</i>	44
<i>Seancat dhe Vendimet e Bordit për Ankesa</i>	44
OBJEKTIVAT E VITIT 2019	46
1. <i>Reformimi i kornizës ligjore</i>	46
2. <i>Implementimi i dixhitalizimit në nivel shtetëror</i>	46
3. <i>Promovimi i Edukimit Medial “Media Literacy”</i>	46
4. <i>Hulumtime dhe analiza</i>	46
5. <i>Identifikim i mangësive aktuale në zbatimin e legjislacionit primar</i>	46
REKOMANDIMET/SFIDAT E INSTITUCIONIT	47
<i>Problemet me buxhetin</i>	47
<i>Nevoja për punëtorë të rinj</i>	47
AUDITIMI I PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN E PËRFUNDUAR ME 31 DHJETOR 2018.....	47

SHTOJCAT

Shtojca I Organogrami

Shtojca II Tabela e Rasteve Ligjore

Shtojca IIIa Raporti Vjetor Financiar

Shtojca IIIb Raporti Vjetor Financiar

Shtojca IV Mbrojtja e Fëmijëve dhe të Miturve në OSHMA

Shtojca V Pajtueshmëria e përmbajtjeve programore të OSHMA-ve me Pjesën 3 të Licencës

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky është raporti me aktivitetet e Komisionit të Pavarur të Mediave (në vazhdim KPM), për periudhën kohore janar-dhjetor 2018, të cilin ju përcjellim në pajtim me Ligjin Nr. 04/L44 për Komisionin e Pavarur të Mediave.

Ashtu siç kërkohet nga Kuvendi, raporti është i ndarë në kapituj ku është bërë prezantimi i mandatit, kompetencave dhe përgjegjësisë të KPM-së.

Raporti i punës së KPM për vitin 2018, përmban të gjitha aktivitetet e zhvilluara gjatë periudhës kohore për të cilën raportohet, amandamentimi dhe miratimi i akteve nënligjore, bashkëpunimi i KPM-së me të licencuarit, bashkëpunimi me organizatat vendore e ndërkombëtare që veprojnë në Republikën e Kosovës dhe bashkëpunimi me rregullatorët në rajon e më gjerë. Poashtu, në raport është dhënë një përmbledhje e pasqyrës së pajtueshmërisë së shërbimeve mediale audio-vizuele, të licencuara nga KPM-ja, me ligjin dhe të gjitha aktet nënligjore të KPM-së, statistikave e numrit të të licencuarve, rastet ligjore të proceduara, shfrytëzimi i spektrit frekuencor në territorin e Republikës së Kosovës, raporti financiar si dhe veprimet e ndërmarra për gjetjet dhe rekomandimet e Zyrës Kombëtare të Auditorit për vitin paraprak.

Edhe për vitin 2019, prioritet i KPM-së mbetet implementimi i procesit të dixhitalizimit sipas Ligjit Nr. 04/L44 për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe Ligjit Nr.05/L-027 për Dixhitalizimin e Transmetimeve Radio Difuzive Tokësore, zhvillimi i pluralizmit medial që u shërben të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës, harmonizimi i akteve nënligjore dhe hartimi i akteve të reja nënligjore që rrjedhin si obligim nga procesi i dixhitalizimit, në harmoni me rregullativën evropiane si dhe zhvillimi i politikës së transmetimit.

Mars 2019

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE

KORNIZA LIGJORE

KPM është organ kushtetues i përcaktuar me nenin 141 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Është themeluar me Ligjin Nr. 04/L-44 për KPM-në i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 2 mars 2012 dhe i cili ka hyrë në fuqi më 20 prill 2012.

Me nenin 3, paragrafin 2.8 të Ligjit për KPM-në përcaktohet që: “*KPM-ja i paraqet Kuvendit të Republikës së Kosovës, deri me 31 mars të vitit vijues një raport vjetor, duke përfshirë edhe të dhënat e plota në lidhje me përcaktimin dhe zbatimin e politikës së transmetimit, dhënien e licencave dhe të ankesave, sanksionet që zbatohen dhe vendimet në lidhje me to, aktivitetet financiare, aktivitetet e tjera të transmetimit si dhe objektivat për vitin e ardhshëm. Raporti vjetor duhet të bëhet publik pas miratimit nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës*”.

PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT

KPM është organ i pavarur, kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit. KPM-ja rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbimet mediale audio dhe audio-vizuele.

Misioni i KPM-së është:

- Të nxisë dhe të mbajë një sistem të drejtë dhe të hapur për licencimin dhe rregullimin e shërbimeve mediale audio-vizuele dhe për menaxhimin e spektrit të frekuencave të transmetimit në pajtim me standardet më të mira ndërkombëtare;
- Të kontribuojë në profesionalizimin e shërbimeve mediale audio-vizuele;
- Të mbështes lirinë dhe pluralizmin e shërbimeve mediale audio-vizuele.

ORGANIZIMI INSTITUCIONAL

Përbërja dhe mandati i anëtarëve të KPM-së

Sipas Ligjit Nr. 04/L-44 për KPM-në, KPM-ja përbëhet nga shtatë (7) anëtarë, të cilët duhet të jenë personalitete të dalluara të fushave të ndryshme si: kultura, arti, drejtësia, kinematografia, gazetaria, biznesi, menaxhmenti, marrëdhënie me publikun, marrëdhënie ndërkombëtare, media dhe teknologjia informative.

Procedura për emërimin e anëtarëve të KPM-së bëhet sipas nenit 11, pika 2.1, të Ligjit për KPM-në, i cili përcakton se: “brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh para kalimit të mandatit të anëtarit të KPM-së apo pas shpalljes së vendit të lirë për arsye të tjera, KPM nxjerr shpalljen publike, brenda një periudhe jo më të shkurtër se afati i përcaktuar me ligj”.

Përbërja e KPM-së gjatë vitit 2018

Emri	Mbiemri	Pozita	i/e emëruar	Kohëzgjatja e mandatit
Muja	FERATI	Kryetar ¹	më 30 maj 2018	mandat 2 (dy) vjeçar
Violeta	HYSENI KELMENDI	Nënkryetare ²	më 17 prill 2018	mandat 4 (katër) vjeçar
Anita	MURIQI	Anëtare	më 30 maj 2018	mandat 2 (dy) vjeçar
Maja	SLAVIQ	Anëtare	më 17 prill 2018	mandat 3 (tre) vjeçar
Vlorë	BERISHA	Anëtare	30 nëntor 2017	mandat 3 (tre) vjeçar
Xhemajl	KRASNIQI	Anëtar	17 nëntor 2016	mandat 4 (katër) vjeçar

Mandati i anëtarëve të KPM-së përcaktohet me short në bazë të nenit 13, paragrafit 2, të Ligjit Nr. 04/L-44 për KPM-në.

Nominimet dhe emërimet e anëtarëve të KPM-së gjatë vitit 2018

Gjatë periudhës raportuese, në periudha të ndryshme kohore, u ka skaduar mandati pesë (5) anëtarëve të Komisionit, dhe Zyra Ekzekutive ka kryer të gjitha procedurat e nominimeve ashtu siç është e përcaktuar me Ligjin për KPM-në. Bazuar në nenin 11, pika 2.1, të Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, KPM fillimisht ka bërë ftesë publike për nominime për tre (3) anëtarë të KPM-së, një (1) nga radhët e komunitetit shqiptar dhe dy (2) nga radhët e komuniteteve jo shqiptare në Republikën e Kosovës. Ftesa publike është bërë më 19 janar 2018 deri më 5 shkurt 2018. Gjatë kësaj periudhe, KPM ka pranuar gjithsejtë tetëmbëdhjetë (18) nominime. Më 6 shkurt 2018, sipas procedurës, KPM i ka përcjellë në Kuvendin e Republikës së Kosovës të gjitha nominimet e pranuar.

¹ z. Muja FERATI është zgjedhur Kryetar i KPM-së në mbledhjen e KPM-së të mbajtur më 21 qershor 2018

² znj. Violeta HYSENI KELMENDI është zgjedhur Nënkryetare e KPM-së në mbledhjen e KPM-së të mbajtur më 21 qershor 2018.

Pastaj, poashtu bazuar në nenin 11, pika 2.1, të Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, KPM ka bërë ftesë publike për nominime për dy (2) anëtarë të KPM-së, nga radhët e komunitetit shqiptar. Ftesa publike është bërë më 1 mars 2018 deri më 15 mars 2018. Gjatë kësaj periudhe, KPM ka pranuar gjithsejtë nëntë (9) nominime. Më 19 mars 2018, sipas procedurës, KPM i ka përcjellë në Kuvendin e Republikës së Kosovës të gjitha nominimet e pranuar.

Kuvendi i Republikës së Kosovës në seancën e mbajtur me 17 prill 2018, ka shqyrtuar rekomandimin e Komisionit Ad Hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Komisionit të Pavarur të Mediave dhe ka zgjedhur dy (2) anëtarë të KPM-së: znj. Violeta Hyseni Kelmendi dhe znj. Maja Slavić. Mandatet e tyre janë përcaktuar me short siç parashihet me nenin 13, paragrafi 2, i Ligjit Nr. 04/L-44 për KPM-në.

Bazuar në Vendimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.06-V-121, datë 17.04.2018, dhe në nenin 11, pika 2.1, të Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, nga radhët e komunitetit jo shumicë, KPM ka bërë ftesë publike për nominime për një anëtarë të KPM-së. Ftesa publike është bërë më 25 prill 2018 deri më 10 maj 2018. Gjatë kësaj periudhe, KPM ka pranuar gjithsejtë gjashtë (6) nominime. Të gjitha nominimet e pranuar, sipas procedurës KPM i ka përcjellë më 18 maj 2018 në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Kuvendi i Republikës së Kosovës në seancën e mbajtur me 30 maj 2018, ka shqyrtuar rekomandimin e Komisionit Ad Hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Komisionit të Pavarur të Mediave dhe ka zgjedhur 2 anëtarë të KPM-së: znj. Anita Muriqi dhe z. Muja Ferati. Mandatet e tyre janë përcaktuar me short siç parashihet me nenin 13, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 04/L-44 për KPM-në.

Bazuar në Vendimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.06-V-179, datë 12.07.2018, dhe në nenin 11, pika 2.1, të Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, nga radhët e komunitetit jo shumicë, KPM ka bërë ftesë publike për nominime për një anëtarë të KPM-së. Ftesa publike është bërë më 19 korrik 2018 deri më 2 gusht 2018. Gjatë kësaj periudhe, KPM ka pranuar gjithsejtë gjashtë (6) nominime. Të gjitha nominimet e pranuar, sipas procedurës, më 9 gusht 2018 KPM i ka përcjellë në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Deri në përfundim të vitit 2018, Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk e ka zgjedhur anëtarin/in e shtatë të Komisionit të Pavarur të Mediave.

Emërimi i anëtarit të tretë të Bordit për Ankesa

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në seancën e mbajtur më 15 mars 2018, ka shqyrtuar rekomandimin e Komisionit Ad Hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtar të Bordit të Ankesave dhe ka emëruar z. Ilaz Rudaku për anëtarë të Bordit për Ankesa me mandat 3 vjeçar, siç parashihet me nenin 40, paragrafin 1, të Ligjit Nr. 04/L-44 për KPM-në. Me emërimin e z. Rudaku, Bordi i Ankesave është në përbërje të plotë.

AKTIVITETET E KPM-së

Në kuadër të aktivitetit institucional dhe në bazë të obligimeve ligjore, gjatë vitit 2018, KPM-ja ka mbajtur dymbëdhjetë (12) mbledhje të rregullta në të cilat ka shqyrtuar dhe ka marrë vendime për çështjet që kanë të bëjnë me zbatimin e Ligjit për KPM-në të cilat janë të paraqitura në këtë raport.

Në vazhdim paraqiten në mënyrë kronologjike dhe të përmbledhur rastet e trajtuara dhe vendimet e marra nga Komisioni gjatë seancave të mbledhjeve të rregullta të vitit 2018.

Mbledhja e parë e KPM-së, e mbajtur më 30 janar 2018

Nga kjo mbledhje ka rezultuar shqyrtimi dhe miratimi i raportit tremujor për periudhën tetor – dhjetor 2017 si edhe shqyrtimi i rastit ligjor, ankesë e KLAN TV kundër operatorit të shpërndarjes ART Motion, lidhur me të drejtën e transmetimit. Pas shqyrtimit të këtij rasti, Komisioni miratoi Rekomandimin e Zyrës Ekzekutive që në pajtim me nenin 5, paragrafi 3, të Rregullores KPM-2016/01, të urdhërojë operatorin e shpërndarjes ART Motion të ndërpresë menjëherë transmetimin e kanalit KLAN TV për faktin që nuk kishte siguruar marrëveshjen valide për transmetim. Në këtë mbledhje, Komisioni ka përcaktuar edhe objektivat për vitin 2018.

Mbledhja e dytë e KPM-së, e mbajtur më 26 shkurt 2018

Në këtë mbledhje, KPM ka shqyrtuar disa kërkesa për licencimin e ofruesve të shërbimit medial audiovizual (OSHMA) përmes operatorëve të shpërndarjes. Pas shqyrtimit të dokumentacionit për secilin rast, Komisioni gjeti se të gjitha kërkesat i kanë plotësuar kriteret ligjore të KPM-së për dhënie të licencës dhe vendosi për miratimin e kërkesave për licencimin e 14 ofruesve të shërbimit medial audiovizual (OSHMA), përmes operatorëve të shpërndarjes: *Beat; Doku 1; Doku 2; Episode; Kino 1; Kino 2; Kino 3; Klan Kosova 2; Prime TV; Kids; Sport 1; Sport 2; Sport 3 dhe TE 7.*

Mbledhja e tretë e KPM-së, e mbajtur më 12 mars 2018

Në këtë mbledhje, KPM ka shqyrtuar tri raste të licencimit, respektivisht kërkesat për ndryshimin e kanaleve për RTK1, RTV21 dhe KTV. Në bazë të nenit 6.2 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së, që ka të bëjë me “Ndryshimet e KPM-së në licencë”, dhe bazuar në gjendjen faktike në terren dhe harmonizimin e Pakos së Licencës, si edhe për të evituar çdo pengesë eventuale në frekuencat e përcaktuara sipas planit ndërkombëtar të ITU-së, Komisioni vendosi të miratojë ndryshimin e kanaleve për RTK1, RTV21 dhe KTV.

Mbledhja e katërt e KPM-së, e mbajtur më 15 mars 2018

Në këtë mbledhje, Komisioni ka shqyrtuar dhe miratuar Raportin Vjetor 2017 për punën e KPM-së dhe ky raport i është dërguar Kuvendit të Republikës së Kosovës, në pajtueshmëri me nenin 3 paragrafi 2.8, të Ligjit Nr. 04/L-44 për KPM-në.

KPM ka shqyrtuar edhe një kërkesë për licencimin e ofruesit të shërbimit medial audiovizual (OSHMA) përmes operatorëve të shpërndarjes, HEKI TV, pas shqyrtimit të të cilës mori vendim për ta licencuar për transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes.

Mbledhja e pestë e KPM-së, e mbajtur më 22 qershor 2018

Kjo ishte mbledhja e parë në përbërje të re, pas zgjedhjes së katër anëtarëve të rinj të Komisionit nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës, rrjedhimisht ishte edhe mbledhje konstituive. Në rend dite ishte vetëm zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkryetarit të KPM-së. Gjashtë nga shtatë anëtarët sa duhet të ketë Komisioni i KPM-së, bënë zgjedhjen e Kryetarit dhe Nënkryetares së Komisionit të Pavarur të Mediave. Pas procesit të votimit të fshehtë dhe numërimit të votave, Kryetar i Komisionit të KPM-së u zgjodh z. Muja FERATI, ndërsa Nënkryetare e KPM-së u zgjodh znj. Violeta HYSENI KELMENDI me mandate dyvjeçare, sipas përcaktimit nga Ligji për KPM-në.

Mbledhja e gjashtë e KPM-së, e mbajtur më 4 korrik 2018

KPM në këtë mbledhje ka trajtuar disa raste ligjore të cilat kishin të bëjnë me Rregulloren KPM-2016/01 për Shpërndarjen e Ofrueseve të Shërbimeve Mediale Audio Vizuele, shkelje të Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale KPM-2016/03 dhe shkelje të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës.

Pas shqyrtimit të ankesave lidhur me pretendimet e shkeljes së Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale KPM-2016/03, Komisioni ka marrë vendime për:

1. TE7 lidhur me ankesën nga znj. Shqipe Pantina; është urdhëruar TE7 që në afat prej pesë (5) ditësh nëpërmes transmetimit t'i kërkojë falje znj. Pantina, ashtu siç përcaktohet me nenin 30, paragrafi 1.2, të Ligjit të KPM-së, si dhe është sanksionuar me gjobë në vlerën prej 2,000 (dy mijë) euro, në pajtim me nenin 30, paragrafi 1.3, të Ligjit të KPM-së, për shkelje të nenit 7 Të drejtat individuale, paragrafi 1, 4 dhe 5, të Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM-2016/03.
2. RTK 1 lidhur me Ankesën nga z. Vesel Ismaili; KPM ka gjetur se RTK 1 ka vepruar në pajtim me Kodin e Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM-2016/03 dhe rrjedhimisht ankesa është refuzuar si e pabazuar.
3. RTK 1 – lidhur me Ankesën nga Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA); është sanksionuar RTK 1 me *Vërejtje*, në pajtim me nenin 30, paragrafi 1.3, të Ligjit të KPM-

së, për shkelje të nenit 6, paragrafi 2, dhe nenit 10, paragrafi 1, të Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM-2016/03.

Ndërsa, për shkelje të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës është shqyrtuar rasti i TV Zoom për të cilin KPM ka gjetur se edhe përkundër Vendimit të Komisionit të KPM-së dhe kërkesave të vazhdueshme, TV Zoom ka vazhduar të veprojë në kundërshtim me nenin 5, paragrafi 2, të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës. Komisioni vendosi që TV Zoom të sanksionohet me pezullimin e gjithë programit për periudhën tre mujore nga momenti i marrjes së Vendimit, për shkelje nenit 5, paragrafi 2, të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës.

Për shkelje të Rregullores KPM-2016/01 për Shpërndarjen e Ofrueseve të Shërbimeve Mediale Audio Vizuele janë shqyrtuar këto raste:

1. Kujtesa Net - Ankesë nga Ipko; operatori i shpërndarjes Kujtesa Net është gjetur në shkelje dhe është sanksionuar me *Vërejte* për shkelje të nenit 5, paragrafi 2, të Rregullores KPM-2016/01.
2. ART Motion –Ankesë nga Ipko; operatori i shpërndarjes ArtMotion është gjetur në shkelje dhe është sanksionuar me *Vërejte* për shkelje të nenit 5, paragrafi 2, të Rregullores KPM-2016/01.
3. Kujtesa Net - operatori i shpërndarjes Kujtesa Net është gjetur në shkelje për shpërndarje të kanaleve pa të drejta të autorit dhe është sanksionuar me gjobë në vlerë prej dy (2,000) mijë euro për shkelje të nenit 4, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2016/01.
4. Max TV - operatori i shpërndarjes Max TV është gjetur në shkelje për shpërndarje të kanaleve pa të drejta të autorit dhe është sanksionuar me gjobë në vlerë prej tre (3,000) mijë euro për shkelje të nenit 4, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2016/01.

Gjithashtu, në këtë mbledhje KPM ka trajtuar edhe disa raste të licencimit:

1. ART Motion - kërkesat për ndryshim të emrit duke i shtuar edhe akronimin “ART” për kanalet ART Doku 1, ART Doku 2, ART Kino 1, ART Kino 2, ART Kino 3, ART Prince Kids , ART Sport 1, ART Sport 2 dhe ART Sport 3.
2. Kutia TV - kërkesë për ndryshim të emrit të Ofruesit të Shërbimit Medial Audiovizual në Premier Songs;
3. TV Net - kërkesë e operatorit kabllor për heqje dorë nga licenca; dhe
4. TV Istogu Chanel - kërkesë për licencim për të vepruar si Ofrues i Shërbimeve Mediale Audio-vizuele (OSHMA) përmes Operatorëve të Shpërndarjes.

Pas shqyrtimit të këtyre rasteve, Komisioni mori vendim të miratojë të gjitha rastet e licencimit të renditura më lartë.

Mbledhja e shtatë KPM-së, e mbajtur më 1 gusht 2018

Në këtë mbledhje, KPM ka shqyrtuar dhe miratuar Raportin Tremujor janar – mars 2018 dhe Raportin Tremujor prill – qershor 2018 për punën e KPM-së.

Komisioni në përbërje të re, sipas procedurës ligjore, vendosi të iniciojë amandamentimin e Rregullores së Punës së Komisionit të KPM-së.

Komisioni shqyrtoi edhe një rast ligjor që kishte të bënte me ankesën e International Maarif Schools of Kosova kundër KTV-së. KPM ka gjetur se KTV ka vepruar në pajtim me Kodin e Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM-2016/03 dhe rrjedhimisht ankesa është refuzuar si e pabazuar.

Komisioni ka trajtuar edhe disa raste të licencimit që ishin kërkesa për ripërtëritje të licencës nga operatorët e shpërndarjes: Kujtesa, Ipko, Eage dhe TV Eho përderisa OSH Elektra kishte kërkuar ripërtëritje të licencës si edhe kërkesë për ndryshim të emrit. Të gjitha kërkesat janë miratuar.

Mbledhja e tetë KPM-së, e mbajtur më 6 shtator 2018

Kjo mbledhje ka filluar me diskutimin në lidhje me punën që është duke u bërë sa i përket procesit të implementimit të Ligjit për Dixhitalizimin e Transmetimeve Tokësore Radiodifuzive, respektivisht lidhur me ndryshimet që duhej të bëheshin në përbërjen e Komisioni Mbikëqyrës. Pas përfundimit të mandatit të ish Kryetarit të KPM-së i cili ka qenë edhe Kryesues ka mbetur me një vend vakant nga përfaqësuesi i KPM-së, prandaj Komisioni vendosi që ta plotësojë këtë pozitë me emërimin e një anëtari të KPM-së. Në këtë detyrë u emërua Kryetari i ri i KPM-së, z. Muja FERATI.

KPM pastaj ka trajtuar një rast ligjor që ka të bëjë me shkelje të Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale KKPM-2016/03, respektivisht me Ankesën nga z.Hetem Terllabuqi kundër TE 7. Komisioni ka marrë vendim me të cilin është urdhëruar TE 7 që në afat prej shtatë (7) ditësh të transmetojë reagimin e palës ankuese ashtu siç përcaktohet me nenin 10, paragrafi 1, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03 dhe është sanksionuar me *Vërejtje*, në pajtim me nenin 30, paragrafi 1, të Ligjit të KPM-së, për shkelje të nenit 6, paragrafi 7, dhe nenit 10, paragrafi 1, të Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM-2016/03.

Gjithashtu, në këtë mbledhje KPM ka trajtuar edhe dy raste të licencimit, respektivisht kërkesën për licencim të kandidatit Kumanova Cable për të operuar si Operator i Shpërndarjes dhe kërkesën e OSHMA K Music për heqje dorë nga licenca. Pas shqyrtimit të këtyre rasteve, Komisioni i miratoi të dyja kërkesat.

Mbledhja e nëntë e KPM-së, e mbajtur më 18 shtator 2018

Komisioni në këtë mbledhje fillimisht ka miratuar Rregulloren e re të Punës dhe ka vazhduar pastaj me trajtimin e një rasti ligjor, ankesa e operatorit IPKO kundër ART Motion për shkelje të Rregullores për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM-2016/01.

Pas shqyrtimit të rastit, Komisioni erdhi në përfundim se ART Motion, ndaj së cilës është parashtruar ankesë nga ana e IPKO, nuk është gjetur në shkelje të Rregullores KPM-2016/01. Prandaj, Komisioni vendosi që ankesa të refuzohet si e pabazuar.

Gjithashtu, Komisioni shqyrtoi edhe një rast tjetër të të drejtave të transmetimit të ngjarjeve sportive nga operatorët e shpërndarjes Kujtesa dhe ART Motion. Komisioni shqyrtoi këtë rast pasi që të dy operatorët e shpërndarjes i kanë deponuar në KPM kontratat e vlefshme të të drejtave të transmetimit për territorin e Republikës së Kosovës, respektivisht Kujtesa në gjuhën shqipe me të drejta ekskluzive dhe ART Motion në gjuhën serbe më të drejta jo ekskluzive.

Pas kërkesës së Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media të Kuvendit të Kosovës, Komisioni miratoi vendimin që operatori i shpërndarjes ART Motion të ndërpresë për kohësisht transmetimin e të gjitha ngjarjeve sportive të UEFA Liga e Kampionëve, UEFA Super Kupa dhe UEFA Evropa Ligë përmes kanalit Arena Sport, deri në sqarimin përfundimtar rreth të drejtave të pretenduara.

Mbledhja e dhjetë e KPM-së, e mbajtur më 26 tetor 2018

Në këtë mbledhje, KPM ka miratuar Raportin Tremujor për periudhën korrik – shtator 2018 për punën e KPM-së për t'u përcjell në Kuvendin e Republikës së Kosovës, sipas procedurës, duke u bazuar në obligimin ligjor që del nga neni 15 i Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave.

Komisioni ka shqyrtuar një rast ligjor lidhur me rastin e ankesës së familjes Shkreli kundër TE7-së, për shkelje të Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM 2016/03. Pas shqyrtimit të këtij rasti, Komisioni ka ardh në përfundim se ankesa e familjes Shkreli, përmes së cilës pretendohet se TE7 i ka shkelur parimet profesionale dhe të kodit të gazetarisë, duke lejuar të transmetohet vetëm pala që pretendon të jetë viktimë, duhet të refuzohet si e pabazuar sepse TE 7 ka vepruar në pajtim me Kodin e Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM 2016/03.

Gjithashtu, në këtë mbledhje KPM ka trajtuar edhe disa raste të licencimit, 2 kërkesa për t'u licencuar si OSHMA për transmetim përmes operatorit të shpërndarjes nga kandidatët: OSHMA Klan News dhe OSHMA RTV Fontana dhe një kërkesë nga Telekom i Kosovës për t'u licencuar si operator i shpërndarjes OTT.

Pas shqyrtimit të tyre, Komisioni i miratoi kërkesat dhe vendosi për licencimin e tyre.

Mbledhja e njëmbëdhjetë e KPM-së, e mbajtur më 6 dhjetor 2018

Komisioni në këtë mbledhje ka shqyrtuar disa raste ligjore që kishin të bëjnë me shkelje të legjislacionit të KPM-së, respektivisht shkelje të Rregullores KPM-2013/01 për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audiovizuale. Lidhur me shkeljet e kësaj rregullore u shqyrtuan pesë (5) raste për OSHMA-të e licencuara : Rrokum TV; TV Mir; TV Syri; TV Prizreni; dhe Tribuna Channel.

Pas shqyrtimit të këtyre rasteve, Komisioni ka ardh në përfundim se të gjitha subjektet e lartpërmendura kanë shkelur nenin 6, paragrafin 3 dhe 4 dhe nenin 7, paragrafin 1 dhe 3, të Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audiovizuale KPM 2013/01. Për këto shkelje Komisioni vendosi sanksionim me Vërejtje si dhe i obligoi të gjitha që në afat prej dhjetë (10) ditësh të bëjnë kategorizimin e përmbajtjeve të cilat i transmetojnë, t'i paralajmërojnë ato para fillimit me sinjal verbal dhe akustik dhe t'i identifikojnë me simbolin përkatës vizual gjatë tërë kohëzgjatjes së tyre sipas kategorizimit të programeve të përcaktuara me Rregulloren KPM-2013/01. Përveç kategorizimit, Komisioni vendosi që të gjitha subjektet e cekura, duke u bazuar në nenin 3 paragrafi 5 të Rregullores KPM-2013/01, të nxjerrin Kodin Praktik në të cilin do të përcaktojnë standardet vetërregulluese për transmetimin e programeve që mund të kenë ndikim të dëmshëm tek fëmijët dhe të miturit, dhe këtë Kod të miratuar ta sjellin në KPM brenda tridhjetë (30) ditësh.

Gjithashtu, në këtë mbledhje KPM ka trajtuar dhe i ka miratuar edhe disa raste licencimi: kandidatët Gurmania Channel dhe Pro 1 janë licencuar të operojnë si OSHMA përmes operatorëve të shpërndarjes ndërsa kandidati Kugo TV është licencuar të operojë si operatori i shpërndarjes, respektivisht si platformë OTT. Kurse TV 21 i është lejuar shfrytëzimi i kanalit 48 ndërsa OSHMA TV Non Stop Shop i është miratuar ndryshim të skemës programore dhe emrit.

Mbledhja e dymbëdhjetë e KPM-së, e mbajtur më 21 dhjetor 2018

KPM, në këtë mbledhje ka shqyrtuar draftet e dy rregulloreve të reja të cilat janë hartuar duke u bazuar në nevojën e rregullimit dhe zhvillimit të tregut medial në Kosovë dhe me qëllim të plotësimit të infrastrukturës ligjore në lidhje me rregullimin e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audiovizuale:

- 1.Draft Rregullore për pronësi të medias dhe parandalim të koncentrimit; dhe
- 2.Draft Rregullore për krijimin e fondit për stimulim të programeve.

Pas shqyrtimit të tyre, Komisioni vendosi që t'i vë ato në diskutim publik për një periudhë tre mujore.

Komisioni gjithashtu ka shqyrtuar dy raste ligjore që kishin të bëjnë me shkelje të legjislacionit të KPM-së, respektivisht shkelje të Kodit të Etikës dhe Rregullores KPM-2013/01 për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-vizuale.

Lidhur me shkeljen e Kodit të Etikës u shqyrtua një ankesë kundër RTK 1. Pas shqyrtimit të këtij rasti, Komisioni erdhi në përfundim se ankesa e palës Gani Geci është e bazuar dhe RTK 1 është gjetur në shkelje të nenit 7, paragrafi 1 dhe 5, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03. Lidhur me këtë, është urdhëruar RTK 1 që në afat prej shtatë (7) ditësh nëpërmes transmetimit t'i kërkojë falje Palës Ankuese për transmetimin e të dhënave personale rreth gjendjes së tij shëndetësore, ashtu siç përcaktohet me nenin 30, paragrafi 1.2, të Ligjit të KPM-së si dhe është sanksionuar RTK 1 me gjobë në vlerën prej 5,000 (pesëmijë) euro, në pajtim me nenin 30, paragrafi 1.3, të Ligjit të KPM-së, për shkelje të nenit 7, paragrafi 1 dhe 5, të Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM-2016/03.

Lidhur me shkelje të Rregullores KPM-2013/01 për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audiovizuale, Komisioni shqyrtoi një rast kundër KTV-së. Pas shqyrtimit të këtij rasti, Komisioni erdhi në përfundim se KTV ka shkelur Rregulloren KPM-2013/01 për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-vizuale dhe e sanksionoi me Vërejtje. Komisioni vendosi që të obligojë KTV që në afat prej dhjetë (10) ditësh të bëjë paralajmërimin e filmave dhe serialeve me sinjal verbal dhe akustik dhe t'i identifikojë me simbolin përkatës vizual gjatë tërë kohëzgjatjes së tyre sipas kategorizimit të programeve të përcaktuara me Rregulloren KPM-2013/01. Gjithashtu, është obliguar KTV që, duke u bazuar në nenin 3, paragrafi 5, të Rregullores KPM-2013/01, të nxjerrë Kodin Praktik në të cilin do të përcaktojnë standardet vetërregulluese për transmetimin e programeve që mund të kenë ndikim të dëmshëm tek fëmijët dhe të miturit dhe këtë Kod të miratuar ta sjell në KPM brenda tridhjetë (30) ditësh.

KPM ka trajtuar edhe disa kërkesa në rastet e licencimit, respektivisht kërkesa për ripërtëritje të licencës për nëntë (9) raste nga: Kosova MTV; 21 Junior; 21 Mix; 21 Plus; Rrokum TV; Zico TV; Business Channel; On TV Channel; dhe 21 Popullore.

Pas shqyrtimit të këtyre rasteve, Komisioni i miratoi kërkesat për ripërtëritje të licencës të OSHMA-ve, të gjitha këto me transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes.

VAZHDIMI I PUNËS NË HARTIMIN DHE AMANDAMENTIMIN E AKTEVE NËNLIGJORE

Konsultimet publike lidhur me aktet nënligjore të KPM-së

Komisioni i Pavarur i Mediave ka vazhduar punën edhe gjatë këtij tremujori të raportimit në amandamentimin e legjislacionit sekondar si dhe hartimin e legjislacionit të ri sekondar në kuadër të përmbushjes së obligimeve ligjore dhe realizimit të planeve dhe objektivave vjetore.

Në këtë drejtim, Komisioni i Pavarur i Mediave në mbledhjen e mbajtur më 21 dhjetor 2018, ka aprovuar për dëgjim publik këto draft rregullore:

- Draft Rregullore për pronësi të medias dhe parandalim të koncentrimit; dhe
- Draft Rregullore për krijimin e fondit për stimulim të programeve.

Bazuar në nenin 8, paragrafi 2, të Ligjit për KPM-në Nr. 04/L-44, KPM u ka bërë ftesë publike përfaqësuesve të shërbimeve mediale audio-vizuale dhe palëve tjera të interesuara për të ofruar komente me shkrim për draft rregulloret e lartpërmendura. Përveç kësaj, KPM gjithashtu do të organizojë dëgjime publike me palët e interesit.

Ndërsa, pas përfundimit të konsultimeve publike më 31 mars, KPM do të shqyrtojë komentet e pranuar, do të inkorporojë ato të cilat janë të bazuara ligjërisht dhe më pas do të procedojë me miratimin e këtyre akteve të reja nënligjore.

RAPORTIMI I KPM-së NË TAKIMET E DIALOGUT TË PROCESIT TË STABILIZIM ASOCIIMIT

Në kuadër të takimeve të Dialogut të Procesit të Stabilizim-Asociimit (DPSA) për “Inovacion, Kapital Njerëzor, Politika Sociale dhe Shoqëri Informative” KPM ka marrë pjesë në takimin e Komitetit të Stabilizim-Asociimit BE – Kosovë, mbajtur më 9 tetor 2018 në Prishtinë. Gjithashtu, KPM ka marrë pjesë edhe në takimin e dytë të Nën-Komitetit për “Drejtësi, Liri dhe Siguri”, të mbajtur më 6 dhe 7 qershor 2018 në Prishtinë. Në këto takime, përfaqësuesit e KPM-së kanë raportuar për zhvillimet institucionale, ecurinë e punës dhe vështirësitë e ndryshme që KPM po përballë në lidhje me plotësimin e kriterëve të BE-së siç janë: përfundimi i procesit të dixhitalizimit të transmetimeve tokësore radio difuzive, harmonizimi i akteve nënligjore të KPM-së me Direktivën për Shërbimet Mediale Audiovizuale (AVMS), si dhe zbatimin e akteve të reja nënligjore të miratura nga KPM e që dalin si obligim nga Ligji për Dixhitalizimin e Transmetimeve Radio Difuzive Tokësore.

KPM ka raportuar edhe lidhur me problemet tjera me të cilat po ballafaqohet institucioni për shkak të mungesës së mjeteve buxhetore, ku në kuadër të të gjitha detyrave dhe veprimeve të lartcekura, buxheti i KPM-së për vitin 2018 ishte zero, si tek hartimi dhe amandamentimi i legjislacionit me atë të Bashkimit Evropian ashtu edhe tek procesi i dixhitalizimit të transmetimeve tokësore radiodifuzive.

ORGANIZIMI I TAKIMEVE REGJIONALE ME MEDIA

Me qëllim të sigurimit të pajtueshmërisë dhe profesionalizmit nga ana e ofruesve të shërbimeve mediale audio-vizuale, KPM mbështetur edhe nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), nga 15 tetor deri me 19 tetor 2018, organizoi një raund të tryezave regjionale në 5 regjione të Kosovës: Mitrovicë, Pejë, Prizren, Gjiilan dhe Prishtinë.

Qëllimi i këtyre vizitave në regjione ishte bashkëbisedimi në mes të KPM-së dhe të licencuarve për çështjet që kanë të bëjnë me përmbajtjet programore të ofruara nga Ofruesit e Shërbimit Medial Audiovizual (OSHMA), mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve nga përmbajtjet e dëmshme programore dhe rolin e mediave në edukimin medial, si dhe vështirësitë, problemet të cilat ata i hasin gjatë zhvillimit të aktiviteteve të tyre.

KPM ka prezantuar shkeljet e gjetura nga monitorimi i OSHMA-ve, ku në bazë të të dhënave nga monitorimi, për shkak të ndryshimeve të theksuara të të dhënave nga ato të deklaruara, është vërejtur nevoja e rishikimit të skemës programore të të gjitha subjekteve transmetuese sepse pas kaq vitesh shumë subjekte aktualisht funksionojnë me skema të reja programore. Gjatë diskutimit nga OSHMA-të lidhur me përfshirjen e fëmijëve në programet e prodhuara dhe problemet me kategorizimin dhe kohën dhe përdorimi i piktogrameve, theks të veçantë iu vu edhe videoklipeve muzikore dhe gjuhës së pa përshtatshme në tekstet e këngëve.

Gjithashtu, është diskutuar edhe çështja e edukimit medial si proces i domosdoshëm dhe roli i medieve në këtë proces. Duke qenë se kjo është një temë e re për të gjithë publikun, u theksua se KPM gjatë vitit 2018 ka vendosur si objektivi edukimin medial dhe është duke punuar në këtë drejtim. Për më tepër, përkushtimi i KPM-së në promovim të edukimit medial është treguar tek ideja për mundësinë e formimit të një fondi për stimulim të OSHMA-ve në të ardhmen për përmbajtje të caktuara programore në interes të publikut që i shërbejnë.

Nga ana e tyre mediat kanë paraqitur vërejtjet e veta e që pak a shumë janë probleme me të cilat përballen sot shumica e tyre në Kosovë. Mediat ballafaqohen me sfida të ndryshme sa i përket prodhimeve të programeve të caktuara vetanake, profesionalizmit dhe formësimit të gazetarëve, mungesës së kuadrove për prodhim programesh, vështirësive për prodhim të programeve për kategori të caktuara të shoqërisë etj. Problemet e mediave lidhen kryesisht me gjendjen e rëndë financiare, e sidomos për shkak të zhvillimit të hovshëm teknologjik. Janë paraqitur pakënaqësi lidhur me përdorimin e gjuhës jo të përshtatshme që mund të merren si fyerje me baza kombëtare, racore, fetare etj.

PUBLIKIMET LIDHUR ME SKEMAT PROGRAMORE DHE PAJTUESHMËRINË E OSHMA-VE ME AKTET NËNLIGJORE

Në vijim të zbatimit të përgjegjësive dhe detyrave ligjore, në kuadër të monitorimit të mediave për pajtueshmërinë e tyre me legjisllacionin në fuqi, Komisioni i Pavarur i Mediave ka publikuar dy raporte të monitorimit të OSHMA-ve lidhur me:

1. Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audiovizuale dhe; dhe
2. Pajtueshmërinë e përmbajtjeve programore të OSHMA-ve me Pjesën 3 të licencës së KPM-së.

Raporti i parë - prezanton të gjeturat nga monitorimi i performancës së OSHMA-ve në lidhje me zbatimin e legjislacionit të KPM-së për mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve në shërbimet mediale audiovizuale. Qëllimi i monitorimit të përmbajtjes programore të OSHMA-ve ishte vlerësimi i pajtueshmërisë së tyre me aktet nënligjore të KPM-së që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve nga përmbajtjet programore si një ndër kategoritë më të rëndësishme dhe gjithashtu më të ndjeshme të publikut. Raporti gjithashtu ofron të dhëna lidhur me respektimin e rregulloreve të KPM-së nga Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audiovizuale në drejtim të mbrojtjes së të miturve dhe fëmijëve nga përmbajtjet që mund të jenë të papërshtatshme ose potencialisht të dëmshme për zhvillimin e tyre ose mirëqenien e përgjithshme të tyre. Ky raport përfshin monitorimin e OSHMA-ve me transmetim tokësor dhe OSHMA-ve me karakter gjeneralistik që operojnë përmes operatorëve të shpërndarjes për të vlerësuar pajtueshmërinë e tyre me aktet nënligjore të KPM-së, kryesisht pajtueshmërinë me Rregulloren për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-Vizuale. Raporti përfshinë njëzetë e shtatë (27) OSHMA për periudhën kohore korrik - shtator të vitit 2018. Të dhënat e dala nga ky raport tregojnë se OSHMA-të në përgjithësi i kushtojnë rëndësi respektimit të obligimeve të dala nga Rregullorja KPM-2013/01, përfshirë edhe çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve nga përmbajtjet e dëmshme programore, me përjashtim të disa OSHMA-ve që janë gjetur të kenë dështuar sa i përket mënyrës së kategorizimit të programeve të caktuara, kohën e transmetimit të tyre si dhe përdorimin e shenjave përkatëse për kategori të caktuara programore. Si përfundim nga ky raport, KPM ka kërkuar nga të gjitha OSHMA-të që të respektojnë me përpikëri rregullat e përcaktuara me legjislacion për mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve nga përmbajtjet e dëmshme programore.

Raporti i dytë - prezanton të gjeturat nga monitorimi i performancës së OSHMA-ve në lidhje me zbatimin e obligimeve të marra nga OSHMA-të lidhur me Pjesën 3 të Licencës së KPM-së, respektivisht pjesën programore. Qëllimi i këtij monitorimi të përmbajtjes programore të OSHMA-ve ishte vlerësimi i pajtueshmërisë së tyre me obligimet ligjore të OSHMA-ve sa i përket respektimit të skemës programore sipas të cilës edhe janë licencuar. Sipas Rregullosë KPM-2017/02 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale përveç tjerash, janë të përkufizuara edhe kriteret programore që parashihen me nenin 6 të Rregullosë, përfshirë pajtueshmërinë e skemës programore javore. Si pjesë përbërëse e Licencës së KPM-së është edhe Pjesa 3 e Licencës që ka të bëjë me formatin e programit javor të të licencuarve. Raporti përfshinë njëzetë e pesë (25) OSHMA për periudhën monitoruese kohore janar-qershor 2018. Sipas mbulimit raporti ka përcaktuar disa kategori gjatë monitorimit: OSHMA me mbulim tokësor nacional, OSHMA me mbulim tokësor lokal dhe regjional, si dhe OSHMA-të që

transmetojnë përmes operatorëve të shpërndarjes. Të dhënat e dala nga ky raport tregojnë se në përgjithësi ka ndryshime të konsiderueshme të të dhënave të deklaruara në raport me të gjeturat nga monitorimi, por në shumicën e rasteve nuk është tejkalluar përqindja (1/4 e kategorisë) e lejuar në Pjesën 3 të Licencës. OSHMA-të në përgjithësi kanë sasi të vogël të programit për fëmijë, përkundër se me këto përqindje edhe janë të licencuara. Po ashtu, është vërejtur se shumica e programeve për fëmijë përbëhet nga muzika për fëmijë dhe filma të huaj vizatimor dhe mungojnë programe edukative/arsimore për fëmijë. Nga të gjitha kategoritë, programi sportiv përbën pothuaj pjesën më të vogël së sasisë së programit javor të OSHMA-ve. Rezultatet e nxjerra nga ky raport i monitorimit si dhe kërkesat e të licencuarve gjatë takimeve regjionale që KPM ka pas me ta, do të pasqyrohen në ndryshimin e Pjesës 3 të Licencës pasi që OSHMA-të të përditësojnë të dhënat për programet që transmetojnë.

BASHKËPUNIMI ME ORGANIZATA VENDORE DHE NDËRKOMBËTARE

Bashkëpunimi në kuadër të platformës evropiane të autoriteteve rregullatore (EPRA)

Në kuadër të platformës EPRA, anëtare e të cilës është KPM nga viti 2003, mundësohet bashkëpunimi dhe shkëmbimi i përvojave me autoritetet evropiane rregullatore për politikat audiovizuale. Ky bashkëpunim realizohet përmes takimeve të rregullta vjetore që organizohen dy herë brenda vitit. Konferenca e EPRA-s është mbajtur më datat 23 deri më 25 maj 2018, në Luksemburg. Natyra e konferencës së EPRA-së është e karakterit të shkëmbimit të përvojave në fushën e rregullimit të mediave, në mes të anëtarëve të kësaj organizate, sfidave me të cilat përballen në këtë fushë, si dhe ofrimin e alternativave për zgjidhjen e këtyre sfidave bazuar në përvojat e ndryshme. Ky takim ishte i 47-ti me radhë i takimeve të rregullta të EPRA-së, nikoqir i së cilës kësaj radhe ishte rregullatori i mediave në Luksemburg. Edhe Komisioni i Pavarur i Mediave ishte i përfaqësuar me zyrtar pjesëmarrës në këtë konferencë ndërkombëtare.

Gjithashtu, pjesëmarrës në këtë konferencë ishin edhe përfaqësuesit e rregullatorëve nga më shumë se 50 vende, anëtare të EPRA-së, përfaqësues të institucioneve relevante evropiane, përfaqësues të instituteve dhe organizatave të ndryshme të cilët merren me fushën e mediave. Në zhvillimin e punimeve në sesionet plenare të konferencës dhe në grupet punuese, si zakonisht morën pjesë gjithashtu edhe përfaqësuesit e KPM-së.

Pikat kryesore të punës janë të renditura shkurtimisht si më poshtë:

- Shërbimi publik dhe përmbajtja e interesit publik në epokën dixhitale;
- Komunikimet Komerciale;
- Sfidat e reja për privatësinë;
- Observatori Audiovizuel Evropian; dhe
- Komunikimet politike dhe sfidat e mediave sociale.

Bashkëpunimi në kuadër të Rrjetit Mediteran të Autoriteteve Rregullatore (MNRA)

KPM është anëtare edhe e MNRA-së, e cila po ashtu ofron mundësinë e marrjes së përkrahjes profesionale nga autoritetet tjera rregullatore për çështje me të cilat ballafaqohet KPM gjatë hartimit të legjislacionit sekondar por edhe në trajtim të çështjeve në baza ditore. MNRA ka organizim të atillë që mban takime të rregullta vjetore në të cilat trajtohen çështje që kanë të bëjnë me rregullimin e transmetimit, mirëpo me fokus më të veçantë në përfaqësimit konkret të grupeve të caktuara në media.

Në mbledhjen e nëntorit 2018, në Barcelonë, janë trajtuar problematikat që kanë të bëjnë me trajtimin e fenomenit të migrimit nga ana e mediave, përfaqësimin gjinor, mediat dhe sigurinë dhe poashtu edhe edukimin medial dhe mbrojtjen e fëmijëve. Në takimin e MNRA-së është diskutuar edhe rishikimi i Direktivës për Shërbimet Mediale Audiovizuale. KPM është e obliguar që legjislacionin sekondar ta harmonizojë me këtë Direktivë dhe falë mundësisë që ofrohet në kuadër të anëtarësimit si të MNRA-së ashtu edhe të EPRA-s informimi dhe parapërgatitja për të rejtat që do të pasojnë në nivel evropian kanë dëshmuar të jenë ndihmesë e madhe për proceset e amandamenteve dhe rishikimeve të rregulloreve përkatëse të KPM-së.

Konferenca rajonale e autoriteteve rregullative të medieve, në kuadër të projektit të Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian “JUFREX”

Konferenca është mbajtur më 5-6 korrik 2018 në Ohër/Maqedoni, ku janë trajtuar tema që kanë të bëjnë me Edukimin Medial dhe Rekomandimet e KE-së lidhur me pluralizmin medial dhe transparencën e pronësisë së mediave, si dhe janë paraqitur analiza krahasuese të praktikave më të mira evropiane lidhur me promovimin e edukimit medial, me theks të veçantë të rolit të rregullatorëve të mediave, në bazë të Rekomandimit të KE-së/Rec (2018)1 mbi pluralizmin medial dhe transparencën e pronësisë së mediave. Po ashtu, janë trajtuar edhe sfidat që janë paraqitur në kohën dixhitale, teknologjisë së zhvilluar, ballafaqimi me çështje që kanë të bëjnë me dezinformimin dhe lajmet e rreme, gjuhën e urrejtjes, nivelin e profesionalizmit gazetaresk. Në këtë temë janë trajtuar edhe format e stimulimeve të programeve mediale, përmes shembujve në vendeve të BE-së, me qëllim të promovimit të diversitetit kulturor, promovim të vlerave demokratike, ofrimit të kualitetit të lartë dhe të llojllojshëm programor etj.

Sa i përket formave të bashkërregullimit dhe vetërregullimit të sektorit medial në vendet e BE-së, janë paraqitur analiza krahasuese të praktikave më të mira evropiane lidhur me vetërregullimin dhe bashkërregullimin, politikat mediale ekzistuese, sfidat e bashkë-rregullimit në fushat e mbrojtjes së fëmijëve, konsumatorëve, etikës gazetareske dhe reklamimit të ushqimit të joshëndetëshëm.

Gjithashtu, në takim është diskutuar lidhur me Rekomandimet e KE-së për rolin dhe përgjegjësinë e ndërmjetësve të internetit – me të cilat kërkohet nga vendet anëtare të ofrojnë

respektimin e të drejtave të njeriut përmes sundimit të ligjit në lidhje me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut në mjedisin dixhital.

Në takim është dakorduar edhe për përgatitjet për publikimin e dytë regional që ka të bëjë me çështjen e mbrojtjes së fëmijëve dhe të miturve nga përmbajtjet programore.

ORGANIZIMI I PUNËTORISË NË BASHKËPUNIM ME KOMISIONIN PARLAMENTAR PËR MEDIA LIDHUR ME NDRYSHIMIN E LIGJIT PËR KPM-në

Me qëllim të plotësimit dhe ndryshimit të Ligjit të KPM-së, në bashkëpunim me Komisionin Parlamentar për Administratë Publike, Qeverisje Lokal dhe Media, KPM ka organizuar takim pune në Tiranë, nga data 30 nëntor deri me datën 3 dhjetor 2018.

Nevoja e ndryshimit dhe plotësimit të legjislacionit primar (Ligjit të KPM-së) ka qenë një prej objektivave të KPM-së e përcaktuar për vitin 2018 si dhe kërkesë e Komisionit Parlamentar për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media.

Fillimisht, KPM ka analizuar nevojat për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të KPM-së dhe ka përgatitur komentet fillestare në formë të ndryshim-plotësimit, të cilat janë prezantuar gjatë takimit punues.

Gjatë kësaj punëtorie, KPM dhe Komisioni Parlamentar janë fokusuar tek pjesët e nevojshme për ndryshim në Ligjin e KPM-së si dhe janë dhënë propozime të reja për plotësim-ndryshimet konkrete që do të jenë pjesë e Draft-Ligjit të ri për Komisionin e Pavarur të Mediave. Pas punëtorisë, KPM ka përcjellë draftin me ndryshimet finale tek Komisioni Parlamentar dhe tani procesi është në vazhdim e sipër sipas procedurës së plotësim-ndryshimit të ligjeve.

PUNA E ZYRËS EKZEKUTIVE

Në kuadër të KPM-së funksionon Zyra Ekzekutive si organ i dytë i këtij institucioni të pavarur. Zyra Ekzekutive udhëhiqet nga Kryeshefja Ekzekutive, e cila e ndihmon Komisionin e KPM-së në realizimin e detyrave dhe përgjegjësisve sipas Ligjit Nr. 04/L-44 për KPM-në.

Në bazë të Ligjit Nr. 04/L-44, Kryeshefja Ekzekutive menaxhon:

- me nëpunësit civilë të KPM-së;
- me financat dhe me burimet tjera të financimit;
- ofron këshilla për politikat e KPM-së;

- siguron zbatimin e vendimeve, politikave dhe masave tjera të KPM-së në mënyrë efektive si dhe;
- bën koordinimin e punëve me institucionet tjera.

Në kuadër të Zyrës Ekzekutive operojnë 4 departamente për Rregullimin e Transmetimit dhe Departamenti i Administratës (*Shtojca 1 Organogrami*):

1. Departamenti i Monitorimit dhe Analizës;
2. Departamenti i Licencimit,
3. Departamenti Ligjor;
4. Departamenti për Menaxhim Frekuencor; dhe
5. Departamenti i Administratës.

Burimet njerëzore

Personeli i Zyrës Ekzekutive janë shërbyes civilë dhe janë të miratuara gjithsej 37 pozita deri në vitin 2018. Ngritja e kapaciteteve njerëzore në Zyrën Ekzekutive, proces ky që është filluar gjatë vitit 2018, pritet të arrijë të rrisë edhe efikasitetin në punën dhe përgjegjësitë e KPM-së në kuadër të zgjerimit të fushës së kompetencës dhe trendit në rritje të numrit të të licencuarve.

DEPARTAMENTI I MONITORIMIT DHE ANALIZËS (DMA)

Departamenti i Monitorimit dhe Analizës (DMA), gjatë vitit 2018, ka vlerësuar pajtueshmërinë e të licencuarve me Ligjin për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe rregulloret e KPM-së.

Rekomandimet e këtij Departamenti, pas monitorimeve të bëra dhe realizimit të aktiviteteve të poshtëshënuara, ishin bazë mbi të cilat departamentet tjera të Zyrës Ekzekutive të KPM-së kanë mbështetur veprimet e mëtutjeshme.

Pajtueshmëria me Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës së KPM-së - Pjesa 3 e Licencës

Licenca e KPM-së përbënë një kontratë të detyrueshme për të Licencuarin që të veprojë në përputhje me Ligjin për KPM-në, me kushtet dhe termet e saj si dhe me të gjitha Pjesët e tjera të Licencës së KPM-së.

Me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë së OSHMA-ve me Pjesën 3 të Licencës, DMA ka realizuar monitorimin e programit të 25 OSHMA-ve, prej tyre: tre (3) TV me mbulim tokësor nacional, gjashtëmbëdhjetë (16) TV me mbulim tokësor regjional/lokal dhe gjashtë (6) OSHMA

Faqe 24 nga 53

që operojnë përmes OSH-ve me status të bartjes së obligueshme. Periudha e monitorimit ka përfshirë programin e transmetuar javor të një subjekti të monitoruar, që është zgjedhur në mënyrë rastësore nga muaji janar deri në qershor të vitit 2018.

Gjithashtu, monitorimi është bërë edhe me qëllim të përpilimit nga ana e KPM-së së listës së OSHMA-ve me statusin e bartjes së obligueshme në operatorët e shpërndarjes, siç përcakton neni 10.5 i Rregullores KPM-2016/01 për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audio-vizuale.

Në kuadër të këtij projekti të monitorimit, janë shikuar, matur dhe analizuar formatet dhe strukturat programore të programit një javor të ofruesve të shërbimeve mediale audio-vizuale, të përzgjedhura në mënyrë të rastësishme nga stafi monitorues. Gjetjet nga këto monitorime janë krahasuar pastaj me të dhënat në Pjesën 3 të Licencës, të cilën subjektet transmetuese e kanë paraqitur me rastin e aplikimit për licencë të KPM-së.

Vlerësimi për pajtueshmërinë me strukturën programore dhe formatin e programit është bazuar në përkufizimet e dhëna në Pjesën 3 të Licencës, sipas të cilave përmbajtjet programore ndahen në: Programe të Shërbimit Publik, Programe Argëtuese, Programe të Prodhimit të Vet, Programe të Ritransmetuara dhe Programe Komerciale nga Jashtë.

Për shkaqe teknike nuk janë përfshirë në monitorim dy televizione lokale: TV ZOOM dhe TV KISS. TV ZOOM nuk ka sjell arkivin e programit sipas kërkesës së KPM-së dhe ka pasur ndërprerje transmetimi për një periudhë të caktuar kohore.

Në shkelje janë gjetur dy (2) OSHMA me transmetim tokësor nacional, njëmbëdhjetë (11) OSHMA me transmetim tokësor lokal/regjional si dhe katër (4) OSHMA që operojnë përmes operatorëve të shpërndarjes.

Pajtueshmëria me Rregulloren KPM 2013/01 për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-vizuale

Me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë me këtë rregullore, janë monitoruar tre (3) OSHMA me transmetim tokësor nacional, gjashtëmbëdhjetë (16) OSHMA me transmetim tokësor lokal/regjional dhe tetë (8) OSHMA që operojnë përmes operatorëve të shpërndarjes. Periudha monitoruese ka qenë tri ditë dhe është zgjedhur në mënyrë rastësore nga muaji korrik deri në shtator të vitit 2018. Në shkelje janë gjetur tetë (8) OSHMA, prej tyre gjashtë (6) OSHMA me transmetim tokësor dhe dy (2) OSHMA që operojnë përmes Operatorëve të Shpërndarjes. Për shkaqe teknike TV ZOOM me transmetim tokësor lokal nuk është monitoruar. TV ZOOM nuk ka sjell arkivin e programit sipas kërkesës së KPM-së dhe ka pasur ndërprerje transmetimi për një periudhë të caktuar kohore.

Në kuadër të këtij monitorimi, është vlerësuar pajtueshmëria me çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve në shërbimet mediale audiovizuale të parapara me këtë rregullore. Shkeljet më të shpeshta kanë pasur të bëjnë me kufizimet dhe obligimet e

përgjithshme të shërbimeve mediale audio-vizuale si: mos paralajmërimi me sinjal akustik apo tekstual para fillimit dhe pas ndërprerjeve të programeve me përmbajtje të dëmshme për fëmijë dhe të mitur, transmetimi i programeve të kategorive të caktuara jashtë kohës së paraparë sipas rregullores, mos përdorimi i simboleve përkatëse vizuale si dhe përdorimi i ngjyrave të shenjave/simboleve përkatëse ndryshe nga ato të përcaktuara në rregullore. Vlen të theksohet se shkeljet më së shumti janë identifikuar gjatë reprizimit të përmbajtjeve programore të transmetuara në terminet e vonshme të ditës, si programe të kategorisë së dytë, tretë dhe katërtë, veçanërisht të filmave artistik dhe serialeve.

Pajtueshmëria me Rregulloren KPM 2017/07 për Komunikimet Komerciale Audio-Vizuale

Vlerësimi i pajtueshmërisë së OSHMA-ve me këtë rregullore është fokusuar në: përmbajtjen e komunikimeve komerciale audiovizuale, produktet dhe shërbimet e reklamuar, ndikimi i tyre te fëmijët dhe të miturit (sipas nenit 9 dhe nenit 16); orari i transmetimit të KKAV-ve dhe teleshopingut për produkte të caktuara (sipas nenit 10); mënyrat e reklamimit (sipas nenit 12); format e reklamimit si: sponsorizimi i programeve për fëmijë (sipas nenit 14) dhe vendosja e produkteve (sipas nenit 15) si dhe dispozita tjera të kësaj rregulloreje.

Lidhur me këtë rregullore janë monitoruar tre (3) OSHMA me transmetim tokësor nacional, dymbëdhjetë (12) OSHMA me transmetim tokësor lokal/regjional dhe shtatë (7) OSHMA që operojnë përmes Operatorëve të Shpërndarjes.

Tetë (8) OSHMA janë gjetur në kundërshtim me këtë rregullore. Shkeljet më të shpeshta të identifikuar kanë pasur të bëjnë me mos dallimin e qartë të komunikimeve komerciale audio-vizuale nga pjesët tjera programore, tejkalim i kohëzgjatjes së reklamimit televiziv dhe teleshopingut, mos paralajmërimi i vendosjes së produkteve dhe sponsorizimit.

Për shkaqe teknike me sistemin e arkivimit të programit të transmetuar, kanë mbetur pa u monitoruar: TV BALLKANI, TV OPINION, TV DUKAGJINI dhe TV TEMA. Kurse, TV ZOOM nuk është duke transmetuar për shkak të mungesës së objektit për realizimin e transmetimit.

Pajtueshmëria me Rregulloren KPM 2013/02 për të Drejtën e Autorit

Gjatë vitit 2018, për vlerësimin e pajtueshmërisë me Rregulloren për të Drejtën e Autorit janë monitoruar tri (3) OSHMA me transmetim tokësor nacional, dymbëdhjetë (12) OSHMA me transmetim tokësor lokal/regjional dhe shtatë (7) OSHMA që operojnë përmes Operatorëve të Shpërndarjes.

Për shkaqe teknike me sistemin e arkivimit të programit të transmetuar kanë mbetur pa u monitoruar: TV BALLKANI, TV OPINION, TV DUKAGJINI dhe TV TEMA. Kurse TV ZOOM nuk është duke transmetuar për shkak të mungesës së objektit për realizimin e transmetimit.

Lidhur me transmetimin e programeve të caktuara e me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë me këtë rregullore, OSHMA-ve të monitoruara u janë kërkuar marrëveshjet valide për të drejtën e autorit. Gjetjet nga këto monitorime kanë dëshmuar se katër (4) OSHMA kanë vepruar në kundërshtim me këtë rregullore.

Pajtueshmëria me Rregulloren për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale dhe Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës së KPM-së për Distribuimin Kabllor të Programeve Radio Televizive në Kosovë

Gjatë vitit 2018, DMA ka realizuar një numër të konsideruar të aktiviteteve karshi objektivave të saj, për të mbikëqyrur zbatimin e legjislacionit të KPM-së nga ana e të licencuarve të tij me statusin e Operatorit të Shpërndarjes (OSH).

Çdo fillim vit, operatorëve të shpërndarjes u kërkohet të deponojnë në KPM katalogët e azhurnuar të kanaleve si dhe marrëveshjet e reja për të drejtat e ritransmetimit të këtyre kanaleve, por edhe përmbajtjeve programore. Nga ky aktivitet, DMA siguron të dhëna të përditësuara në lidhje me të drejtat e ritransmetimit të Operatorëve të Shpërndarjes, por edhe ofertën e tyre programore për qytetarët.

Gjatë vitit 2018, DMA ka kryer 41 monitorime të ndryshme lidhur me pajtueshmërinë e Operatorëve të Shpërndarjes. Nga ky numër, tetëmbëdhjetë (18) monitorime janë bërë në bazë të ankesave nga industria mediale. Këto ankesa për subjekt trajtimi kishin pajtueshmërinë e një numri të konsiderueshëm të Operatorëve të Shpërndarjes, por edhe operimeve ilegale pa licencë të KPM-së. Lidhur me këto raste, DMA në bashkëpunim edhe me departamentet tjera, ka realizuar monitorime në terren në gjithë territorin e Republikës së Kosovës, duke verifikuar rastet e tilla, dhe më pas duke ndërmarrë veprime konkrete varësisht nga natyra e rasteve.

Raportet e monitorimit lidhur me shkeljet e gjetura të Operatorëve të Shpërndarjes janë proceduar për trajtim të mëtutjeshëm te Departamenti Ligjor.

Ankesat e Parashtruara dhe rastet Ex officio

Gjatë vitit 2018, DMA ka pranuar dhe shqyrtuar pesëmbëdhjetë (15) ankesa lidhur me KKPM-2016/3 Kodi i Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës, prej tyre dy ankesa kanë rezultuar si të pabazuara dhe jashtë kompetencës së KPM-së. Lidhur me ankesat si dhe rastet *ex officio* për të cilat është pretenduar se ka pasur shkelje gjatë transmetimit të përmbajtjeve të caktuara programore, DMA ka bërë monitorime dhe analiza të detajuara. Gjetjet dhe rekomandimet pas shqyrtimit të ankesave lidhur me shkeljet e pretenduara, ishin bazë mbi të cilat departamentet tjera kanë vazhduar procedurat e mëtutjeshme.

Në përgjithësi, shkeljet kishin të bëjnë me të drejtën individuale, sulme personale ndaj individëve, ndërhyrje në çështjet thjeshtë private apo personale të cilat nuk kanë ndikim në interesin publik, mos transmetimi i reagimit përkatës, mos ofrimi i të drejtës për reagim, mos ndërmarrja e veprimeve të duhura për evitimin e përdorimit të gjuhës vulgare ose ofenduese nga ana e pjesëmarrësve në program, mbrojtja e të dhënave personale dhe mos korrigjimi i informacionit të publikuar që është gjetur të jetë i pasaktë.

Vizitat/ Inspektimet

DMA gjatë vitit 2018, ka realizuar vizita dhe inspektime tek OSHMA-të me qëllim të njoftimit për të arriturat e OSHMA-ve, për problemet dhe shqetësimet e tyre, si dhe në rastet e ankesave për transmetime pa të drejtën e autorit dhe operime ilegale janë realizuar inspektime në terren me qëllim të monitorimit të subjekteve lidhur me pajtueshmërinë me bazën ligjore të KPM-së.

DEPARTAMENTI I LICENCIMIT

Numri i përgjithshëm i të licencuarve në Republikën e Kosovës

Departamenti i Licencimit është përgjegjës për shqyrtimin e kërkesave për licenca të reja për ofrues të shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale, përfshirë edhe shqyrtimin e kërkesave që kanë të bëjnë me ndryshime të kushteve dhe termeve të përgjithshme të licencës së KPM-së. Gjithashtu, Departamenti i Licencimit është përgjegjës për mirëmbajtjen e një regjistri për të gjithë të licencuarit e KPM-së. Kështu që, gjatë vitit 2018 kanë operuar gjithsej 20 TV Stacione, 83 Radio Stacione, 41 Operator të Shpërndarjes dhe 80 Ofrues të Shërbimeve Mediale Audiovizuale (OSHMA), të cilët ofrojnë programet e tyre vetëm përmes rrjetit të Operatorëve të Shpërndarjes.

Numri i TV dhe Radio stacioneve të licencuara sipas gjuhëve:

Të licencuara 20 TV stacione:

- *1 TV stacion publik;*
- *13 TV stacione në gjuhën shqipe;*
- *5 TV stacione në gjuhën serbe;*
- *1 TV stacion në gjuhën turke.*

Të licencuara 83 Radio stacione:

- *2 radio stacione të transmetuesit publik;*
- *48 radio stacione në gjuhën shqipe;*
- *23 radio stacione në gjuhën serbe;*
- *3 radio stacione në gjuhën boshnjake;*
- *3 radio stacione në gjuhën turke;*
- *2 radio stacione në gjuhën gorane;*

- 1 radio stacion në gjuhën rome;
- 1 radio stacion multietnik.

Numri i Operatorëve të Shpërndarjes (OSH) të licencuar:

Të licencuar 41 operatorë të shpërndarjes:

- 36 operatorë të shpërndarjes të licencuar me pronarë shqiptar;
- 1 operatorë të shpërndarjes të licencuar me pronarë boshnjak/goran;
- 4 operatorë të shpërndarjes të licencuar me pronarë serb.

Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale (OSHMA) të cilët transmetojnë përmes Operatorëve të Shpërndarjes

Gjithsej janë të licencuar 80 Ofrues të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audio-vizuale (OSHMA), të cilët ofrojnë programet e tyre vetëm nëpërmjet rrjetit të operatorëve të shpërndarjes:

- 68 OSHMA janë të licencuar të transmetojnë program në gjuhën shqipe;
- 8 OSHMA janë të licencuar të transmetojnë program në gjuhën serbe; dhe
- 3 OSHMA janë të licencuar të transmetojnë program në kuadër të Transmetuesit Publik RTK (RTK 2; RTK News dhe RTK Art).

Shqyrtimi i kërkesave

Gjatë vitit 2018, Departamenti i Licencimit (D-LIC) ka regjistruar 65 raste për shqyrtim, e të cilat kanë të bëjnë me: kërkesa për licencë të OSHM-ve me transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes, kërkesa për licencë të operatorëve të shpërndarjes, kërkesë për ndryshimin e emrit të subjektit të licencuar, kërkesa për ndryshim të pronësisë, kërkesa për ripërtëritje të licencës, njoftime për heqje dorë nga licenca, kërkesa për ndryshim të skemës programore si dhe kërkesa tjera që lidhen me kushtet dhe termet e përgjithshme të licencës së KPM-së.

D-LIC ka përgatitur rekomandimet për rastet e licencimit, të cilat i ka prezantuar para anëtarëve të KPM-së për shqyrtim dhe mbi bazën e atyre rekomandimeve janë marrë vendime.

Në përgjithësi, gjatë vitit 2018 janë marrë këto vendime për licencim:

- 18 vendime për licencimin e OSHMA-ve të cilët transmetojnë përmes operatorëve të shpërndarjes;
- 3 vendime për licencimin e operatorëve të shpërndarjes;
- 14 vendime për ripërtëritje të licencës;
- 2 vendime për ndërprerje të licencës (pas njoftimit për heqje dorë në mënyrë vullnetare nga licenca e KPM-së); dhe

- 16 vendime për ndryshimin e emrit (në një rast me vendim për ndryshim të emrit është ndryshuar edhe skema programore).

Rastet të cilat janë mbyllur pa pasur nevojë për vendim të Komisionit, gjithsej 1:

1 rast lidhur me ndryshimin e pronësisë (kandidati ka heq dorë nga kërkesa).

Rastet që janë bartur për shqyrtim në vitin 2019, janë gjithsej 12 raste:

- 3 kërkesa për ripërtëritje të licencës;
- 5 kërkesa për heqje dorë nga licenca;
- 1 kërkesë për licencë të operatorit të shpërndarjes;
- 1 kërkesë për ndryshim të skemës programore;
- 1 kërkesë për bartje të licencës; dhe
- 1 kërkesë për zgjerim të mbulimit – frekuencë shtesë.

DEPARTAMENTI LIGJOR

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2018 ka shqyrtuar raste të ndryshme të Ofruesve të shërbimeve mediale audiovizuale (tutje OSHMA) dhe Operatorëve të shpërndarjes (tutje OSH) për shkelje të dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe akteve nënligjore të KPM-së. Departamenti Ligjor gjatë vitit 2018 ka shqyrtuar edhe raste tjera në bazë të ankesave të personave fizik dhe juridik të parashtruara kundër OSHMA dhe OSH.

Rastet e proceduara në bazë të shkeljes së dispozitave ligjore të Ligjit për KPM-në dhe akteve nënligjore të KPM-së³ janë kategorizuar dhe paraqitur si në vijim:

Rastet për transmetim ilegal-Shkelja e nenit 21, paragrafi 1 dhe nenit 30 paragrafi 5 e Ligjit 04/L-44 të KPM-së

Gjatë vitit 2018 Departamenti Ligjor ka proceduar një (1) rast për shkelje të nenit 21, paragrafi 1, të Ligjit të KPM-së, i cili përcakton se: “Për të ushtruar transmetim në Kosovë sipas kushteve të këtij Ligji kërkohet licenca për transmetim të cilin e lëshon KPM-ja”, dhe nenit 30, paragrafi 5, i Ligjit të KPM-së, i cili përcakton se: “Kushdo që operon pa leje transmetimi valide, i konfiskohet aparatura përkatëse për transmetim. Subjekti i tillë transmetues nuk mund të ankohet tek Bordi për Ankesa”.

Departamenti Ligjor i KPM-së i ka dërguar Njoftim për Shkelje këtij Operatori të shpërndarjes për operim ilegal. Ky operator ka dështuar të veprojë në pajtueshmëri për t’u pajisur me licencë të KPM-së, rasti bartet për vitin 2019 për procedim të mëtutjeshëm.

Rastet e Shkeljes së Ligjit Nr. 04/L-44 të KPM-së, nenit 28 - Mos sjellja e Raportit vjetor

³ Shih Shtojcën II “Paraqitja Tabelare e Rasteve Ligjore”

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2018 ka proceduar nëntëdhjetë (90) raste për mos sjellje të raportit vjetor. Të gjithë të licencuarve të cilët kanë dështuar të veprojnë në pajtim me nenin 28 të Ligjit të KPM-së u janë dërguar Njoftime për shkelje si veprim i parë procedural dhe njoftues. Pas dërgimit të Njoftimit për shkelje nga ana e Departamentit Ligjor dyzetëntë (49) nga këto subjekte transmetuese kanë ardhur në pajtueshmëri dhe si raste janë mbyllur. Ndërsa, rastet për dyzetënjë (41) subjekte transmetuese tjera barten për vitin 2019 për procedim të mëtutjeshëm. Nëse këta ofrues të shërbimeve mediale audiovizuale dështojnë të dorëzojnë raportin vjetor në KPM edhe për vitin pasues atëherë Departamenti Ligjor do t'i rekomandojë Komisionit shqiptimin e masave më të ashpra sanksionuese, në pajtim me nenin 30 të Ligjit të KPM-së.

Rastet për shkelje të Rregullores KPM-2017/07 për Komunikime Komerciale Audiovizuale

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2018 ka proceduar tetë (8) raste kundër OSHMA që janë gjetur në shkelje të Rregullores KPM-2017/07 për Komunikime Komerciale Audiovizuale. Të gjitha këto subjekte kanë pranuar Njoftime për shkelje si veprim i parë procedural dhe njoftues. Nëse këto subjekte në të ardhmen dështojnë të veprojnë në pajtim me Rregulloren KPM-2017/07, atëherë Departamenti Ligjor do t'i rekomandojë Komisionit shqiptimin e masave më të ashpra sanksionuese në pajtim me nenin 30 të Ligjit të KPM-së.

Ndërsa, një Ofrues i shërbimeve mediale edhe pas pranimit të Njoftimit për shkelje ka dështuar të veprojë në pajtueshmëri me Rregulloren për Komunikime Komerciale Audiovizuale KPM-2017/07, dhe për këtë Komisioni i KPM-së ka marrë Vendim me masën sanksionuese Vërejtje. Rasti është mbyllur.

Rastet për shkelje të Rregullores KPM-2013/01 për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-Vizuale

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2018 ka proceduar tetë (8) raste kundër OSHMA-ve lidhur me shkeljen e Rregullores KPM 2013/01 për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-Vizuale. Të gjitha këto subjekte kanë pranuar Njoftime për shkelje si veprim i parë procedural dhe njoftues. Edhe pas pranimit të Njoftimeve për shkelje të gjitha këto OSHMA kanë dështuar të veprojnë në pajtueshmëri me Rregullores KPM 2013/01 për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-Vizuale dhe për këtë Komisioni i KPM-së ka marrë Vendim që të sanksionohen me Vërejtje. Rastet janë mbyllur. Nëse këto subjekte në të ardhmen dështojnë të veprojnë në pajtim me Rregulloren KPM- 2013/01, atëherë Departamenti Ligjor do t'i rekomandojë Komisionit shqiptimin e masave më të ashpra sanksionuese në pajtim me nenin 30 të Ligjit të KPM-së.

Rastet për shkeljen e Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2018 ka proceduar katërmëdhjetë (14) raste kundër OSHMA-ve lidhur me shkeljen Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës.

Rastet për shkelje të Pjesës së tretë të licencës janë këto OSHMA: TV Mitrovica, TV Prizreni, First Channel, Rrokum TV, TV Festina, TV Opinion, TV Tema, Zico TV, TV 21, TV Mir, TV

Kim, TV Prizreni dhe TV Most, të cilat pas pranimit të Njoftimit për shkelje kanë ardhur në pajtueshmëri dhe si raste ligjore janë mbyllur.

Rasti tjetër i shkeljes së Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës është edhe mossjellja e arkivit nga TV Zoom, i cili ka dështuar ta sjellë arkivin dhe në bazë të Rekomandimit të Departamentit Ligjor, Komisioni i KPM-së mori Vendim që ta sanksionojë TV Zoom-in me pezullimin e gjithë programit për periudhë tre mujore. Rasti është mbyllur.

Rastet për shkeljen e Rregullores KPM-2017/06 për Tarifën Vjetore për Licencë - Mos pagesa e tarifës për licencë

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2018 i ka dërguar në përmbarrim tetëdhjetë (80) Ofrues të Shërbimeve Mediale Audiovizuale të cilat nuk e kanë paguar tarifën për licencë për vitin 2018.

Rastet për shkeljen e Rregullores KPM-2016/01 për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2018 ka proceduar dyzetënjë (41) raste të shkeljeve dhe ankesave të Operatorëve të Shpërndarjes (OSH).

Departamenti Ligjor iu ka dërguar Njoftime për shkelje të gjithë këtyre OSH. Pas Njoftimeve për shkelje disa nga OSH kanë ardhur në pajtueshmëri dhe rastet janë mbyllur. Ndërsa, për OSH të cilët kanë vazhduar të vepronë në kundërshtim me Rregulloren KPM-2016/01, në bazë të Rekomandimeve të Departamentit Ligjor, i është rekomanduar Komisionit të KPM-së ndërmarrja e masave sanksionuese. Komisioni pas rekomandimeve të Departamentit Ligjor për shkeljet Rregulloren KPM-2016/01 me masën sanksionuese *Vërejtje* ka dënuar këto OSH: Artmotion dhe Kujtesa Net. Po ashtu, edhe për OSH Artmotion Komisioni pas Rekomandimit të Departamentit Ligjor për shkeljet Rregullores KPM-2016/01, mori Vendim që Artmotion të ndërpresë transmetimin e të gjitha ngjarjeve sportive të UEFA. Rastet janë mbyllur.

Për shkeljen e Rregullores KPM-2016/01 pas Rekomandimit të Departamentit Ligjor Komisioni me masën sanksionuese me gjobë në shumë prej dymijë (2.000) euro e ka dënuar OSH Kujtesa Net. Rasti është mbyllur.

Rastet për shkeljen e Rregullores KPM-2017/02 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2018 ka proceduar një (1) rast kundër OSH lidhur me shkeljen e Rregullores KPM-2017/02 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale.

Departamenti Ligjor i ka dërguar Njoftim për Shkelje OSH Artmotion për shkelje të Rregullores KPM-2017/02, pas pranimit të Njoftimit për shkelje ka vepruar në pajtueshmëri. Rasti është mbyllur.

Rastet për shkeljen e Rregullores KPM-2013/02 për të Drejtën e Autorit

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2018 ka proceduar tetë (8) raste kundër OSHMA-ve lidhur me shkeljen e Rregullores për të Drejtën e Autorit KPM 2013/02.

Departamenti Ligjor iu ka dërguar Njoftime për shkelje të gjithë këtyre OSHMA-ve për shkelje të Rregullores KPM-2013/01, pas pranimit të Njoftimeve shtatë (6) prej tyre kanë vepruar në pajtueshmëri. Të gjitha këto subjekte do të monitorohen sërish për të vlerësuar pajtueshmërinë me Rregulloren KPM-2013/02. Ndërsa, Tribuna Channel edhe pas Njoftimit për Shkelje ka dështuar të veprojë në pajtueshmëri me Rregulloren KPM-2013/02, Komisioni me Rekomandim të Departamentit Ligjor e ka dënuar me masë sanksionuese me gjobë në shumën prej njëmijë (1.000) euro. Rastet janë mbyllur. Vetëm rasti i TV Prizrenit bartet për procedim për vitin 2019.

Rastet dhe Kërkesat tjera të proceduara nga KPM gjatë vitit 2018, rastet e shkeljes së Kodit të Etikës KKPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës

Janë proceduar katërbëdhjetë (14) raste:

1. Rasti i parë është proceduar bazuar në Ankesën e Agjencionit të Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA) ndaj OSHMA RTK 1. Ankesa i referohet një kronike të transmetuar në edicionin qendror të lajmeve në RTK 1 në të cilën janë trajtuar problemet e sigurisë në Aeroportin e Prishtinës. ASHNA ka bërë ankesë me pretendimin se RTK 1 nuk ka kërkuar përgjigje nga ASHNA lidhur me këtë çështje. KPM me qëllim të shqyrtimit të ankesës ka bërë monitorimin e kronikës dhe ka gjetur se RTK 1 ka bërë shkelje të Kodit të Etikës KKPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës dhe për këtë KPM i ka dërguar Njoftim për shkelje RTK 1. Edhe pas Njoftimit për shkelje RTK 1 ka dështuar t'i ofrojë ASHNA-së të drejtën e demantit në afat prej shtatë (7) ditësh. Në bazë të Rekomandimit të Zyrës së KPM-së Komisioni i KPM-së mori Vendim që ta dënojë RTK 1 me Vërejtje. Vendimi u është dërguar dy palëve. Rasti është mbyllur.
2. Rasti i dytë është proceduar bazuar në Ankesën e z. Vesel Ismajlit ndaj OSHMA RTK 1. Ankesa i referohet emisionit “Betimi për Drejtësi”, me pretendimin se gjatë emisionit atij i janë shkelur të drejtat individuale, duke raportuar përmbajtje programore të pasakta dhe lajme jo të vërteta, qasje të njëanshme, mos dallim ndërmjet lajmit dhe opinionit dhe shprehjeve jo adekuate e denigrues me qëllim të denigrimit të personalitetit të tij. KPM me qëllim të shqyrtimit të Ankesës ka bërë monitorimin e programit dhe ka gjetur se RTK 1 nuk ka bërë shkelje të Kodit të Etikës KKPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës. Në bazë të Rekomandimit të Zyrës së KPM-së Komisioni i KPM-së mori Vendim që Ankesa e Palës ankuese të refuzohet si e pabazuar. Rasti është mbyllur.
3. Rasti i tretë është proceduar bazuar në Ankesën e znj. Shqipe Pantinës ndaj OSHMA TE 7. Ankesa i referohet kronikës “Afera e Topallit me Pantinën”, me pretendimin se gjatë transmetimit të kësaj kronike janë shkelur të drejtat individuale, ndërhyrje në çështjet private dhe personale si dhe sulm në ndershmërinë, integritetin apo cilësinë personale si

person. KPM me qëllim të shqyrtimit të Ankesës ka bërë monitorimin e programit dhe ka gjetur se TE 7 ka bërë shkelje të Kodit të Etikës KKPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës dhe për këtë KPM i ka dërguar kërkesë për sqarim lidhur me Ankesën TE 7. Pas kërkesës për sqarim TE 7 është përgjigjur duke kundërshtuar pretendimet e Palës ankuese, duke theksuar se publikimi i kësaj kronike ka qenë në interes të publikut. Në bazë të Rekomandimit të Zyrës së KPM-së Komisioni i KPM-së mori Vendim që ta dënojë TE 7 me gjobë në vlerë prej dymijë (2.000) euro. Vendimi u është dërguar dy palëve. Rasti është mbyllur.

4. Rasti i katërt është proceduar bazuar në Ankesën e Maarif School of Kosova ndaj OSHMA KTV. Ankesa i referohet një kronike të transmetuar në lajmet qendrore, me pretendimin se përmes transmetimit të kësaj kronike është dëmtuar reputacioni dhe imazhi i shkollës duke raportuar se shkollat Maarif janë jashtë kontrollit të Ministrisë së Arsimit, duke mos respektuar udhëzimin e MASHT-it lidhur me respektimin e kodit të veshjes, respektivisht bartjen e shamisë. KPM me qëllim të shqyrtimit të Ankesës ka bërë monitorimin e programit dhe ka gjetur se KTV nuk ka bërë shkelje të Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM 2016/03. Në bazë të Rekomandimit të Zyrës së KPM-së, Komisioni i KPM-së mori Vendim që Ankesa e Palës ankuese të refuzohet si e pabazuar. Vendimi u është dërguar Palës ankuese. Rasti është mbyllur.
5. Rasti i pestë është proceduar bazuar në Ankesën e z. Hetem Terllabuqit ndaj OSHMA TE 7. Ankesa i referohet kronikës “Fqinjët në Vushtrri në hall me njëri tjetrin”, të transmetuar në edicionin qendror të lajmeve, me pretendimin se TE 7 përmes kësaj kronike ka shkelur parimet profesionale dhe kodit të gazetarisë, duke lejuar të prononcohet vetëm pala që pretendohet të jetë viktimë, ndërsa emrat tjerë të përmendur gazetarja nuk i ka kontaktuar për të marrë opinionet e tyre lidhur me këtë kronikë. KPM me qëllim të shqyrtimit të Ankesës ka bërë monitorimin e programit dhe ka gjetur se TE 7 ka bërë shkelje të Kodit të Etikës KKPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës dhe për këtë KPM i ka dërguar Njoftim për shkelje TE 7. Në bazë të Rekomandimit të Zyrës së KPM-së, Komisioni i KPM-së mori Vendim që ta dënojë TE 7 me Vërejtje. Vendimi u është dërguar dy palëve. Rasti është mbyllur.
6. Rasti i gjashtë është proceduar bazuar në Ankesën e Familjes Shkreli ndaj OSHMA TE 7. Ankesa i referohet kronikës “Fqinjët në Vushtrri në hall me njëri tjetrin”, të transmetuar në edicionin qendror të lajmeve, me pretendimin se TE 7 përmes kësaj kronike ka shkelur parimet profesionale dhe kodit të gazetarisë, duke lejuar të prononcohet vetëm pala që pretendohet të jetë viktimë, ndërsa emrat tjerë të përmendur gazetarja nuk i ka kontaktuar për të marrë opinionet e tyre lidhur me këtë kronikë. KPM me qëllim të shqyrtimit të Ankesës ka bërë monitorimin e programit dhe ka gjetur se TE 7 nuk ka bërë shkelje të Kodit të Etikës KKPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës, pasi që Palës ankuese i është ofruar e drejta e reagimit dhe i është kërkuar falje publike familjes dhe personave të përmendur në këtë kronikë. Në bazë të Rekomandimit të Zyrës së KPM-së, Komisioni i KPM-së mori Vendim që Ankesa e Palës ankuese të refuzohet si e pabazuar. Vendimi u është dërguar dy palëve. Rasti është mbyllur.

7. Rasti i shtatë është proceduar bazuar në Ankesën e z. Gani Gecit ndaj OSHMA RTK 1. Ankesa i referohet kronikës “Për thirrjet për etikë për mediat që vijnë nga Kosova” të transmetuar në edicionin qendror të lajmeve, me pretendimin se gjatë transmetimit të kësaj kronike RTK 1 ka shkelur politika redaktuese të saj për shkak se lajmi i publikuar nuk ka pasur përmbajtje informuese, përveç se me qëllime tendencioze për cenimin dhe denigrimin e personalitetit të z. Geci. KPM me qëllim të shqyrtimit të Ankesës ka bërë monitorimin e programit dhe ka gjetur se RTK 1 ka bërë shkelje të Kodit të Etikës KKPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës dhe për këtë KPM i ka dërguar Njoftim për shkelje RTK 1. Në bazë të Rekomandimit të Zyrës së KPM-së, Komisioni i KPM-së mori Vendim që ta dënojë RTK 1 me gjobë në vlerë prej pesëmijë (5.000) euro. Vendimi u është dërguar dy palëve. Rasti është mbyllur.
8. Rasti i tetë është proceduar bazuar në Ankesën e z. Milaim Sejdit ndaj OSHMA RTK 1. Ankesa i referohet kronikës “Përmirësimet në Arsim”, të transmetuar në edicionin qendror të lajmeve, me pretendimin se në kronikën e transmetuar ka pasur qasje të njëanshme, lajm të pa balancuar, nuk është bërë dallimi në mes të opinionit dhe lajmit si dhe shprehjet e përdorura gjatë transmetimit të lajmit janë bërë me qëllim të denigrimit të personalitetit të Palës ankuese. KPM me qëllim të shqyrtimit të Ankesës ka bërë monitorimin e programit dhe ka gjetur se RTK 1 ka bërë shkelje të Kodit të Etikës KKPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës dhe për këtë KPM i ka dërguar Njoftim për shkelje RTK 1, me të cilin i është kërkuar trajtimi i drejtë dhe i paanshëm i Palës ankuese. Në bazë të Rekomandimit të Zyrës së KPM-së, Komisioni i KPM-së mori Vendim që ta dënojë RTK 1 me gjobë në vlerë prej dymijë (2.000) euro. Vendimi u është dërguar dy palëve. Rasti është mbyllur.
9. Rasti i nëntë është proceduar bazuar në Ankesën e z. Fatmir Spahiut ndaj OSH IPKO. Ankesa i referohet ritransmetimit të filmit “Distant Angle” pa marrëveshje, me pretendimin se produkti BUKA ka të drejtën ekskluzive të ritransmetimit të këtij filmi në Republikën e Kosovës. KPM me qëllim të shqyrtimit të Ankesës ka bërë monitorimin e programit dhe ka gjetur se IPKO ka ritransmetuar filmin “Distant Angle” përmes kanalit TVSH. KPM me qëllim të vlerësimit të kësaj çështjeje ka analizuar kontrata e IPKO-s për të drejtën e ritransmetimit të TVSH-së të deponuar në KPM, ku nga vlerësimi i bërë i këtyre kontratave ka rezultuar se kontrata e lidhur me TVSH ka skaduar. IPKO ka bartur kanalit TVSH pa të drejtë ritransmetimi, duke bërë shkelje të Rregullores KPM-2016/01 për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale dhe për këtë KPM i ka dërguar Njoftim për shkelje IPKO-s, përmes të cilit ka kërkuar të veprojë në pajtim me Rregulloren KPM-2016/01, duke ndërprerë menjëherë ritransmetimin e kanalit TVSH. KPM i ka dërguar shkresë Palës ankuese lidhur me ankesën. Rasti është mbyllur.
10. Rasti i dhjetë është proceduar bazuar në Ankesën e z. Petrit Hysaj ndaj OSHMA TV LLAPI. Ankesa i referohet ritransmetimit të videoklipit muzikor me titull “Për Familje” të transmetuar nga TV LLAPI, me pretendimin se ky videoklip ka përmbajtje eksplicite dhe të papërshtatshme për moshat nën 18 vjeç. KPM me qëllim të shqyrtimit të Ankesës ka bërë monitorimin dhe vlerësimin e videoklipit muzikor dhe ka gjetur se është i papërshtatshëm për audiencën dhe se mund të promovojë dukuri negative, duke bërë

shkelje të Kodit të Etikës KKPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës dhe për këtë KPM i ka dërguar Njoftim për shkelje TV LLAPI-t, duke kërkuar që të veprojë në pajtim me Kodin e Etikës KKPM-2016/03. Rasti është mbyllur.

11. Rasti i njëmbëdhjetë është proceduar nga Zyra Ekzekutive me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë të Radio Prishtina me Kodin e Etikës KKPM 2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës. KPM ka bërë monitorimin e emisionit “Drive Time me Shukin” emisioni i cili transmetohet çdo ditë nga e hëna deri të premten në valët e Radio Prishtina. Zyra Ekzekutive e KPM-së bazuar në Raportin e monitorimit ka gjetur se ky emision përmban gjuhë dhe shprehje të papranueshme e vulgare edhe pavarësisht që gjatë kohës së transmetimit paralajmërohet për gjuhën e përdorur ka vazhduar të veprojë në kundërshtim me Kodin të Etikës KKPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës dhe për këtë KPM i ka dërguar Njoftim për shkelje Radio Prishtina, duke kërkuar që të veprojë në pajtim me Kodin e Etikës KKPM 2016/03. Rasti është mbyllur.
12. Rasti i dymbëdhjetë është proceduar në bazë të Kërkesës nga hetuesi policor z. Faton Zabërgja drejtuar Zyrës Ekzekutive për asistim lidhur me monitorimin e operatorëve të cilët dyshohet se janë duke kryer vepra të cilat cenojnë të drejtat e autorit. KPM i është përgjigjur me shkrim lidhur me Kërkesën e hetuesit policor, duke njoftuar se mandati i KPM-së sa i përket transmetimit të kanaleve pa marrëveshje mbi të drejtat e autorit në parim shtrihet mbi operatorët e licencuar të cilët marrin obligime ligjore për respektimin e të drejtës së transmetimit. Vlerësimi i pajtueshmërisë së tyre me të drejtën e autorit verifikohet përmes monitorimit të kanaleve të transmetuara në operatorin e licencuar përkatës. Ndërsa, procedurat për operatorët e palicencuar zhvillohet mbi bazën e operimit ilegal pa licencë të KPM-së dhe bëhet konfiskimi i pajisjeve të transmetimit, me çka i pamundësohet operatorëve të vazhdojnë veprimtarinë ilegale të transmetimit. KPM duke marrë parasysh faktin se veprimet e tilla janë në interes të vendosjes së ligjshmërisë në fushën e transmetimit dhe do të kontribuojnë në luftimin e piraterisë si interes i përbashkët i institucioneve do të ofrojë asistencë në çdo rast duke respektuar mandatin kushtetues dhe ligjor. Rasti është mbyllur.
13. Rasti i trembëdhjetë është proceduar në bazë në Ankesës së Kadria NET ndaj operatorit ilegal Kleris Net. Ankesa i referohet operatorit të shpërndarjes Kleris Net i cili operon ilegalisht në emër të Kujtesa Net, me pretendimin se ky operator përmes shërbimit IPTV transmeton pa të drejtë kanalet e platformës Digitalb dhe Tring. KPM me qëllim të shqyrtimit të Ankesës ka komunikuar me operatorin e shpërndarjes Kujtesa Net, të cilët kanë deklaruar se nuk kanë marrëveshje bashkëpunimi me Kleris NET. KPM ka bërë monitorimin, mirëpo nuk ka qenë e mundur të vërtetohet se nga kush është duke u ofruar shërbimi IPTV. KPM i është përgjigjur me shkresë Palës ankuese duke e njoftuar që sipas kompetencave ligjore nuk posedon ndonjë mekanizëm tjetër për verifikimin e këtyre pretendimeve ankimore dhe se KPM është në kontakt të vazhdueshëm me Policinë e Kosovës me qëllim të identifikimit sa më të shpejtë dhe ndërmarrjen e masave ligjore ndaj operatorëve ilegal të cilët ushtrojnë veprimtari transmetuese në mënyrë ilegale. Rasti është mbyllur.

14. Rasti i katërmbëdhjetë është proceduar në bazë të Ankesës së TRING TV ndaj operatorit ilegal Kleris Net. Ankesa i referohet Operatorit të shpërndarjes Kleris Net i cili operon ilegalisht në emër të Kujtesa Net, me pretendimin se ky operator përmes shërbimit IPTV transmeton pa të drejtë kanalet e platformës Digitalb dhe Tring. KPM me qëllim të shqyrtimit të Ankesës ka komunikuar me Operatorin e shpërndarjes Kujtesa Net të cilët kanë deklaruar se nuk kanë marrëveshje bashkëpunimi me Kleris NET. KPM ka bërë monitorimin, mirëpo nuk ka qenë e mundur të vërtetohet se nga kush është duke u ofruar shërbimi IPTV. KPM i është përgjigjur me shkresë Palës ankuese duke e njoftuar që sipas kompetencave ligjore nuk posedon ndonjë mekanizëm tjetër për verifikimin e këtyre pretendimeve ankimore dhe se KPM është në kontakt të vazhdueshëm me Policinë e Kosovës me qëllim të identifikimit sa më të shpejtë dhe ndërmarrjen e masave ligjore ndaj operatorëve ilegal të cilët ushtrojnë veprimtari transmetuese në mënyrë ilegale. Rasti është mbyllur.

DEPARTAMENTI I MENAXHIMIT FREKUENCOR

Analiza e Spektrit Frekuencor – Transmetimet analoge

Gjatë vitit 2018, janë monitoruar radio televizionet nacionale, radio televizionet regjionale e lokale me qëllim të verifikimit të pajtueshmërisë së zonës së mbulimit me pjesën e dytë dhe të katërt të Licencës. Gjithashtu, janë monitoruar edhe frekuencat radio që i shfrytëzojnë KFOR-i, UNMIK-u dhe radio stacionet e huaja ndërkombëtare për nevojat e tyre.

Të dhënat nga kontrollet dhe matjet dëshmojnë se shfrytëzimi i spektrit frekuencor në territorin e Kosovës vazhdon të mbetet përafërsisht i njëjtë në krahasim me situatën në vitin 2017, me përjashtim të numrit të madh të sinjaleve radio dhe TV që vijnë nga vendet fqinje (Serbia, Maqedonia dhe Shqipëria).

Mbulueshmëria me sinjal televiziv në nivel nacional (RTK, KTV, RTV21)

Nga matjet në terren dhe analizat e bëra, vërtetohet se gjendja e mbulueshmërisë me sinjale TV të subjekteve transmetuese nacionale është e një kualiteti shumë të mirë 65 dBuV/m për TV dhe e pa interferuar për ato lokacione që i mbulojnë, dhe se zona e shërbimit është në pajtueshmëri me pjesën e dytë e të katërt të licencës. Megjithatë, duhet të theksohet se nga raportet e mëhershme, mbulimi i tërësishëm i territorit të Kosovës nuk është i kënaqshëm. Aktualisht, territori i Republikës së Kosovës mbulohet vetëm me 62,7% me sinjal televiziv. Regjione të tëra si: Dragashi, Kaçaniku, Zhupa, Kamenica, Klina, Artana, Zveçani, Zubin Potoku dhe Leposaviqi kanë mbetur në tërësi apo pjesërisht jashtë zonës së mbulimit me sinjal televiziv për shkak të problemit të vazhdueshëm të mos aktivizimit të pikës së lartë të Goleshit, për transmetim primar televiziv si dhe mos aktivizimi i rrjetit sekondar (rrjeti i përsëritësve televiziv). Në këtë kontekst, KPM-ja në vazhdimësi ka informuar organet më të larta shtetërore të Republikës së Kosovës, për rëndësinë e aktivizimit të kësaj pike për transmetim televiziv.

Pika e lartë e Goleshit përdoret vetëm nga KFOR-i për transmetime radio FM. Për të siguruar mbulueshmëri më të gjerë me sinjal televiziv është shumë e rëndësishme që kjo pikë të aktivizohet edhe për subjektet transmetuese televizive.

Maja e Goleshit është e regjistruar në ITU, respektivisht në të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare që nga Stokholm 61, Gjeneva 84, 89 dhe e fundit Gjeneva 2006, si pikë kryesore e transmetimit për Kosovën. Për këtë arsye janë të rezervuara dhe të pranuar ndërkombëtarisht kanale transmetimi radio e televizive me fuqi të mëdha rrezatimi. Me aktivizimin e kësaj pike të lartë të Goleshit për transmetim televiziv, do të rritej zona e mbulimit nga 62.7% (me nivel të sinjalit të kënaqshëm prej 60 dBuV/m) në 80% të territorit të Kosovës dhe do të mundësohej zhvillimi i rrjeti sekondar, ashtu që do të arrihej që mbi 90% e territorit të Kosovës të mbulohet me sinjal televiziv kualitativ.

Mbulueshmëria me sinjal Radio FM në nivel nacional (Radio Kosova 1, Radio Kosova 2, Radio 21 dhe Radio Dukagjini)

Gjatë vitit 2018, Departamentit për Menaxhim Frekuencor (DMF) ka bërë matjet në kuadër të përcaktimit të objektivave të KPM-së për vitin 2018, të cilat kanë patur për qëllim sigurimin e mbulueshmërisë së zonave të veçanta gjeografike të territorit të Republikës së Kosovës (me theks të veçantë rrugët magjistrale dhe regjionale) me sinjal kualitativ të të licencuarve me mbulim nacional në radio në brezin frekuencor VHF/FM (87.5 - 108 MHz).

DMF-ja gjatë matjeve të bëra në terren ka vërtetuar gjendjen e njëjtë si gjatë vitit paraprak që tregon se, në disa zona të caktuara, Radio Kosova 1, Radio Kosova 2, Radio 21 dhe Radio Dukagjini nuk ofrojnë mbulim të mirë, ndërsa, niveli i sinjalit të mbulueshmërisë është nën nivelin e duhur të 54 dBuV/m. Matjet teknike janë bërë në disa rrugë magjistrale si: Prishtinë-Gjilan (Slivovë, Llabjan, Parlllovë dhe Bresalc); Kacanik – Hani i Elezit; Mitrovicë – Bajgorë; Shtime – Carralevë, Dragash – Restelicë; Prizren – Brezovicë; Kramovik – Dollc; Pejë – Rugovë; Kamenicë, dhe është vërejtur se në këto zona nuk ka fare pranim të sinjalit të radiove nacionale.

Në bazë të këtyre rezultateve, KPM konstaton se Radio Kosova 1, Radio Kosova 2, dhe Radio 21 nuk janë duke transmetuar në pajtim me parametrat teknikë siç janë të përcaktuara me Pjesën 2 të licencës së KPM-së, ndërsa Radio Dukagjini në koordinim me KPM-në është duke bërë zgjerimin e zonës së mbulimit në tërë territorin e Kosovës.

Me gjithë rekomandimin e bërë nga ana e KPM-së për radiot nacionale që të transmetojnë në pajtim të plotë me parametrat teknikë të përcaktuara në Pjesën 2 të Licencës së KPM-së me qëllim të ngritjes së cilësisë së sinjalit të transmetimit si dhe shërbimin më cilësor në zonat e përcaktuara me licencë të KPM-së, radiot nacionale nuk janë përgjigjur fare, me përjashtim të Radio Dukagjinit, në lidhje me veprimet që kanë ndërmarrë.

KPM është e gatshme që të sigurojë frekuenca shtesë me qëllim të mbulimit të zonave ku nuk ka fare sinjal, ndërsa, në bashkëpunim me ta edhe të gjenden lokacionet e përshtatshme për pika të transmetimit.

Mbulimi me sinjal televiziv në nivel regjional dhe lokal

Nga matjet në terren dhe analizat e bëra vërtetohet se gjendja e mbulueshmërisë me sinjale TV dhe radio të subjekteve transmetuese është e një kualiteti shumë të mirë (60 dBuV/m për TV dhe 54 dBuV/m për FM radio transmetime) dhe e painederuar për ato lokacione që i mbulojnë dhe se zona e shërbimit është në pajtueshmëri me pjesën e dytë dhe të katërt të licencës.

Televizionet regjionale – lokale mbulojnë rreth **68.14%** të territorit të Kosovës me sinjal televiziv ndërsa, radiot lokale/regjionale mbulojnë rreth **96.98%** të territorit të Kosovës.

Rastet për interferencë

Gjatë vitit 2018, DMF ka pranuar pesë ankesa për interferencë nga subjektet transmetuese radio Radio Star (Gjilan), Radio Glam (Prishtinë), Radio Dukagjini (Pejë) Radio Plus (Prishtinë) dhe Top Iliria Radio.

Raport i monitorimit lidhur me ankesën e Radio Dukagjinit sipas së cilës është i ndërferuar nga Radio Maria në regjionin e Prizrenit. Pas matjeve është konstatuar se Radio Maria është duke shkaktuar interferenca në frekuencën e Radio Dukagjinit. Pas rekomandimeve të KPM-së për rregullimin e këtij problemi interferencat e paraqitura janë eliminuar.

Raporti i monitorimit lidhur me ankesën e Radio Star sipas të cilës është i ndërferuar nga Radio Gjilani dhe nga Radio Rinia. Pas matjeve në terren, është konstatuar se Radio Gjilani dhe Radio Rinia kanë probleme me sistemin e transmetimit ku si rezultat shkaktojnë interferenca në brezin FM. Pas rekomandimeve të KPM-së për rregullimin e këtij problemi, interferencat e paraqitura janë eliminuar.

Raporti i monitorimit lidhur me ankesën e Radio Glam sipas së cilës është i ndërferuar nga Radio Prishtina. Pas matjeve në terren është konstatuar se problemi me interferencë nuk ekziston dhe se Radio Glam është e pa ndërferuar.

Rastet për transmetime të pa licencuara

DMF, gjatë vitit 2018, nga matjet në terren ka konstatuar praninë të sinjalit nga pika e Goleshit nga TV Nacionale komerciale pa miratim të KPM-së, ku pas disa takimeve dhe arsytimit këto frekuenca janë licencuar nga KPM që të shfrytëzohen për transmetim analog nga kjo pikë.

Frekuencat e revokuara nga KPM

DMF, gjatë vitit 2018, nuk ka proceduar me asnjë rast për të cilën është dashur të revokohet ndonjë frekuencë (licencë).

Monitorime të radio frekuencave ndërkombëtare dhe bashkëpunimi me KFOR

DMF, gjatë vitit 2018, ka bërë edhe monitorime të frekuencave radio që janë në shfrytëzim të KFOR-it, UNMIK-ut dhe radiostacioneve të huaja ndërkombëtare me qëllim të azhurnimit të bazës së të dhënave që posedon KPM-ja. Gjatë vitit 2018, radiot e huaja ndërkombëtare BBC, VOA dhe RFI vazhdojnë transmetimet e tyre.

Frekuencat për transmetime radio FM që i përdor KFOR-i, UNMIK-u dhe radiostacionet e huaja ndërkombëtare, nuk i janë nënshtruar procesit të licencimit afatgjatë, dhe si të tilla mund të paraqesin interferencë në të ardhmen për shkak të mos instalimit të filtrave dalës.

Ndërsa, bashkëpunimi i KPM-së me KFOR është duke vazhduar për të siguruar pikën e lartë të Goleshit si zonë transmetuese e lirë dhe opsionet për të arritur këtë mbesin të trajtohen përmes Marrëveshjeve të Mirëkuptimit në mes institucioneve relevante kosovare dhe KFOR-it.

Gjatë vitit 2018, KPM ka pasur një bashkëpunim shumë të mirë me KFOR-in sa i përket aspektit të frekuencave FM, ku si rezultat KFOR i ka kthyer KPM-së tri frekuencat të cilat i ka shfrytëzuar dikur dhe se tani nuk i shfrytëzon më.

Kërkesa për ndryshim të lokacionit të transmetimit

Gjatë vitit 2018, DMF nuk ka pranuar ndonjë kërkesë për ndryshim të lokacionit (pikës për transmetim).

Raste të ndryshimit të lokacionit të transmetuesit pa miratim të KPM-së

Gjatë vitit 2018, DMF nuk ka proceduar me ndonjë rast të subjekteve transmetuese të cilat kanë bërë ndryshimin e pikës së transmetimit pa miratimin e KPM-së.

Subjektet transmetuese të cilat kanë ndërprerë transmetimin tokësor, ose kanë zvogëluar zonën e mbulueshmërisë:

Gjatë vitit 2018, TV regjionale si TV Besa, TV Prizreni dhe TV Iliria kanë ndërprerë transmetimin tokësor, ku edhe pas njoftimeve (rekomandimeve) nga KPM-ja për fillim të transmetimit, kanë filluar transmetimin.

TV Zoom nuk ka transmetuar sinjal TV në transmetim tokësor në kanalën për të cilin është i licencuar nga KPM-ja.

TV Ballkan nuk ka transmetuar sinjal TV në transmetim tokësor në kanalën për të cilin është i licencuar nga KPM-ja.

Gjatë vitit 2018, TV nacionale me transmetim nga pika e Cernushes, pikë kjo për mbulim në zonën e Mitrovicës nga matjet e bëra në terren është konstatuar se nuk janë duke punuar sipas pjesës dy të licencës (kanë bërë zvogëlimin e fuqisë transmetuese). Pas njoftimit nga KPM lidhur

me këtë është konstatuar se TV Nacionale nga pika Cernush kanë filluar transmetimin konform licencës së KPM-së.

Kërkesë për frekuencë shtesë dhe frekuenca të reja:

Gjatë vitit 2018, KPM ka pranuar kërkesë për frekuenca shtesë vetëm nga Radio Dukagjini, ndërsa nga radiot tjera nacionale nuk kemi pasur kërkesa të tilla. Të gjitha radiot regjionale lokale transmetojnë me nga vetëm një frekuencë.

Gjatë vitit 2018, DMF ka bërë matje në tërë territorin e Republikës së Kosovës lidhur me gjetjen dhe përditësimin e frekuencave të lira Radio FM dhe TV.

Plani frekuencor dhe dixhitalizimi

Gjatë vitit 2018, DMF ka bërë përditësimin e planit të frekuencave për transmetim tokësor televiziv dixhital në Republikën e Kosovës, si obligim nga Ligji për Dixhitalizim në Republikën e Kosovës.

Gjatë vitit 2018, DMF ka bërë matje në terren lidhur me verifikimin e kanaleve të cilat janë ndarë nga ITU për transmetim dixhital në territorin e Republikës së Kosovës. Nga këto matje është konstatuar se këto kanale nuk janë të interferuara nga vendet fqinje.

Gjatë vitit 2018, DMF ka punuar në hartimin e draft të dosjes së tenderit për dixhitalizim, përkatësisht pjesës teknike që do të vendosen në këtë dokument dhe specifikimet teknike për hartimin e projekt propozimit për planifikimin e ndërtimit të rrjetit dixhital në territorin e Republikës së Kosovës.

DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS DHE FINANCAVE

Buxheti

Komisioni i Pavarur i Mediave është organizatë buxhetore e financuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës.

Gjatë periudhës raportuese kemi ndryshime të buxhetit fillestar ndaj buxhetit final. Ndryshimet janë bërë duke u bazuar në Vendimin e Qeverisë me nenin 15, 16 dhe 29 të Ligjit Nr. 03/L-048.

Bazuar në këto vendime, nga kategoria e pagave është tërhequr shuma në vlerë prej 95,267.13 € dhe në kategorinë e shërbimeve komunale shuma në vlerë prej 1,496.43 €.

Buxheti fillestar paraqet buxhetin e aprovuar sipas Ligjit për ndarjet buxhetore, të ndarë sipas kategorive ekonomike. Buxheti fillestar në vlerë prej 826,322.94 € në krahasim me buxhetin final është zvogëluar në vlerë prej 729,559.38 €.

Për periudhën janar - dhjetor 2018, KPM-ja nga Buxheti final i ndarë në vlerë prej 729,559.38 € ka shpenzuar buxhetin në vlerë prej 696,438.45 € apo 95 %.

Buxheti i Komisionit të Pavarur i Mediave për vitin 2018				
Kategoritë	Buxheti Fillestar	Buxheti Final	Buxheti i shpenzuar	Buxheti i pashpenzuar
Pagat dhe mëditjet	450,338.99	355,071.86	355,071.86	0.00
Mallra dhe Shërbime	347,983.95	347,983.95	318,143.86	29,840.09
Shërbime Komunale	28,000.00	26,503.57	23,222.73	3,280.84
Total:	826,322.94	729,559.38	696,438.45	33,120.93

Në kategorinë e pagave dhe mëditjeve, buxheti fillestar në vlerë prej 450,338.99 € në krahasim me buxhetin final është zvogëluar në vlerë prej 355,071.86 € dhe janë shpenzuar mjete në vlerë prej 355,071.86 € apo 100%.

Në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve buxheti i ndarë është në vlerë prej 347,983.95 €. Vlera totale e shpenzuar në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve është 318,143.86 € apo 91 %.

Në kategorinë e shërbimeve komunale, buxheti fillestar në vlerë prej 28,000.00 € në krahasim me buxhetin final është zvogëluar në vlerë prej 26,503.57 € dhe janë shpenzuar mjete në vlerë prej 23,222.73 € apo 88%.

Bazuar në Ligjin për KPM-në dhe Rregulloren për Nivelin dhe Mënyrën e Pagesës së Tarifës për Licencë KPM-2017/03, të licencuarit janë të obliguar të paguajnë tarifën vjetore për licencë. KPM, duke u bazuar në mandatin ligjor, ka mbledhur tarifatat vjetore të licencës nga të licencuarit, përfshirë këtu tarifatat për aplikim, ndryshim dhe vazhdim të licencës të cilat sipas Ligjit të KPM-së do të duhej të plotësonin buxhetin për nevojat e KPM-së. Edhe përkundër përcaktimit ligjor se

të hyrat nga tarifa për licencë duhet ta plotësojnë buxhetin e KPM-së, deri më tani KPM-së nuk i është mundësuar alokimi dhe shfrytëzimi i këtyre mjeteve.

KPM prej tarifës së licencës për vitin 2018 ka planifikuar që të realizoj të hyra në vlerë prej 240,880.00 €.

KPM nga të hyrat e mbledhura prej tarifës për licencë dhe gjobave të shqiptuara ka mbledhur gjithsej 222,534.16 € Në këtë shumë është përfshirë vlera e të hyrave nga tarifa për licencë me vlerë prej: 214,194.16 € dhe të hyrat nga gjobat që kanë rezultuar nga vendimet sanksionuese në vlerë prej 8,340.00 €, të cilat janë regjistruar direkt në Buxhetin e Kosovës.

Gjatë periudhës raportuese, kemi një rritje prej 16,171.14 € apo 7.27% më shumë krahasuar me të hyrat e realizuara në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Të gjitha obligimet tjera nga tarifa për licencë dhe gjobat të cilat kanë statusin e të arkëtueshmeve në vlerë prej 604,530.28 €, janë si pasojë e mos pagesave të obligimeve për pagesën e tarifës së licencës dhe gjobave. Nga shuma totale 78,160.00 € janë obligime financiare nga të licencuarit për vitin 2018, dhe 526,370.28 € janë obligime të trashëguara nga vitet paraprake.

KPM-ja, për obligimet për mos pagesën e tarifës vjetore për licencë, ka proceduar për ekzekutim në Gjykatën Themelore dhe te përmbaruesi privat. Ndërsa, obligimet tjera financiare për mos pagesë të gjobës janë në procedurë të ekzekutimit përmes përmbarimit privat.

Gjatë periudhës raportuese, kemi një rritje të llogarive të arkëtueshme prej 59,291.37 € apo 9.81% më shumë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Në Shtojcën IIIb është dhënë Raporti buxhetor i detajuar, i cili paraqitet edhe në Ministrinë e Financave dhe në Zyrën Kombëtare të Auditimit (***Shtojca IIIb Raporti Vjetor Financiar***).

PUNA E BORDIT PËR ANKESA

Bordi për Ankesa (BA) është organ i pavarur në bazë të nenit 36 të Ligjit për KPM-në. Bordi i Ankesave shqyrton ankesat e palëve që drejtpërdrejt kanë të bëjnë me Vendimet e Komisionit të KPM-së. Bordi për Ankesa përbëhet prej tre (3) anëtarëve të cilët emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Nga radhët e anëtarëve të Bordit për Ankesa, Kuvendi zgjedh Kryetarin. Anëtarët e Bordit për Ankesa emërohen me mandat tre (3) vjeçar.

Përbërja e Bordit gjatë vitit 2018

Emri	Mbiemri	Pozita	i/e emëruar	Kohëzgjatja e mandatit
Avdyl	HYSENI	Kryetar	16 qershor 2016	mandat 3 (tre) vjeçar
Musa	DRAGUSHA	Anëtar	16 qershor 2016	mandat 3 (tre) vjeçar
Ilaz	RUDAKU	Anëtar	15 mars 2018	mandat 3 (tre) vjeçar

Seancat dhe Vendimet e Bordit për Ankesa

Bordi për Ankesa (BA), gjatë vitit 2018, ka mbajtur pesë (5) seanca shqyrtuese, ku ka shqyrtuar tri (3) ankesa ndaj vendimeve të Komisionit të KPM-së. Bordi për Ankesa në një seancë të veçantë ka vendosur për ndryshim/plotësimin e Rregullores së Punës, në pajtim me nenin 42 të Ligjit të KPM-së Nr. 04/L-44.

Rastet të cilat janë shqyrtuar nga ana e Bordit për Ankesa ndaj Vendimeve të Komisionit të KPM-së, gjatë vitit 2018, janë si në vijim:

1. Ankesa e RTP e parashtruar me datën 2 korrik 2018. Bordi për Ankesa, në seancën e mbajtur me datën 13 korrik 2018, vendosi ta hedh poshtë ankesën për shqyrtim pasi që Bordi për Ankesa shqyrton vetëm ankesat ndaj Vendimeve të Komisionit të KPM-së.
2. Ankesa e Operatorit të Shpërndarjes Armotion e parashtruar me datën 26 korrik 2018. Bordi për Ankesa, në seancën e mbajtur me datën 1 gusht 2018, vendosi të refuzojë si të pa bazuar ankesën e Operatorit të Shpërndarjes Armotion dhe e vërtetoi Vendimin e Komisionit të KPM-së.

3. Ankesa e OSHMA TE 7, e parashtruar me datën 13 gusht 2018. Bordi për Ankesa, në seancën e mbajtur me datën 29 gusht 2018, vendosi ta hedh poshtë ankesën e TE 7 dhe e vërtetoi Vendimin me gjobë në shumë prej dymijë (2000) euro, të shqiptuar nga ana e Komisionit të KPM-së për shkelje të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.
4. Ankesa e Operatorit të Shpërndarjes Max TV e parashtruar me datën 6 gusht 2018. Bordi për Ankesa, në seancën e mbajtur me datën 29 gusht 2018, vendosi ta ndryshoj Vendimin e KPM-së, duke e zbritur shumën e gjobës tremijë (3000) euro në shumë prej një mijë (1000) euro, të shqiptuar nga ana e Komisionit të KPM-së për shkelje të Rregullores për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM-2016/01.
5. Ankesa e Maarif School of Kosova, e parashtruar më datën 07 gusht 2018. Bordi për Ankesa, në seancën e mbajtur me datën 21 shtator 2018, vendosi të refuzojë si të pa bazuar ankesën e Maarif School of Kosova dhe e vërtetoi Vendimin e Komisionit të KPM-së.
6. Ankesa e Operatorit të Shpërndarjes Artmotion, e parashtruar me datën 19 shtator 2018. Bordi për Ankesa, në seancën e mbajtur me datën 28 shtator 2018, vendosi ta aprovojë ankesën si të bazuar të Operatorit të Shpërndarjes Artmotion si të dhe të anulojë Vendimin e KPM-së dhe vendosi që çështja të kthehet në rivendosje.

OBJEKTIVAT E VITIT 2019

1. Reformimi i kornizës ligjore

- Hartimi i pakos së licencës për operatorë të MUX;
- Hartimi i pakos së licencës për OSHMA përmes MUX dhe Rregullores për Vlerësimin e Aplikacioneve për këta të licencuar; dhe
- Plotësimi i Rregullores për Taksën për Licencë.

2. Implementimi i dixhitalizimit në nivel shtetëror

- Përgatitja dhe shpallja e tenderit për kanalet 46 dhe 58.

3. Promovimi i Edukimit Medial “Media Literacy”

- Definimi dhe hartimi i udhëzuesit relevant;
- Përcaktimi i roleve/obligimeve/përgjegjësi;
- Krijimi i një platforme ndër-institucionale për promovim dhe zhvillim;
- Planifikimi i aktiviteteve.

4. Hulumtime dhe analiza

- Hulumtime dhe analiza për shikueshmërinë dhe dëgjueshmërinë e mediave.

5. Identifikim i mangësive aktuale në zbatimin e legjislacionit primar

- Ligji i KPM-së;
- Rregulloret e KPM-së.

REKOMANDIMET/SFIDAT E INSTITUCIONIT

(problemet me buxhetin, rritja e numrit të stafit)

Problemet me buxhetin

Shkurtime të buxhetore, që KPM ka pasur vazhdimisht, po pamundësojnë funksionimin si një institucion i pavarur dhe po rrezikon përmbushjen e objektivave të parapara për vitet e ardhshme.

Nevoja për punëtorë të rinj

Për disa vjet radhazi, KPM kërkon shtimin e stafit, duke u bazuar në kërkesat reale që ndërliken me zgjerimin e fushëveprimit të KPM-së, marrë parasysh edhe faktin se numri i të licencuarve nga KPM është rritur dukshëm dhe se shtimi i volumit të detyrave për nëpunësit ekzistues është trefishuar. KPM-ja ka paraqit kërkesa në vazhdimësi dhe ende nuk është aprovuar kjo rritje e numrit të punëtorëve. Aktualisht, KPM është duke u ballafaquar me mungesë të theksuar të stafit dhe si rezultat i kësaj në vazhdimësi ka ngarkesa në punë, të cilat po rezultojnë edhe me pamundësinë e kryerjes së detyrave sipas pritjeve. Kjo gjendje gjithsesi mund të ketë edhe efekte negative sa i përket zbatimit të rregulloreve dhe procedurave në punë. Mungesa e stafit do të vështirësojë edhe punën e KPM-së në zbatimin e Ligjit të KPM-së dhe atij për Dixhitalizimin e Transmetimeve Radiodifuzive Tokësore.

AUDITIMI I PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN E PËRFUNDUAR ME 31 DHJETOR 2018

Nr	Rekomandimi ose gjetja	Veprimi i ndërmarrë ose propozuar	Afati i zbatimit	Efekti
1.	Rekomandimi nr. 1 Kryetari i Komisionit duhet të sigurohet se <u>Marrëveshjet për shërbime të veçanta</u> përdoren vetëm për qëllimin e caktuar, të planifikohen drejtë dhe të bëhen në pajtim me kërkesat ligjore në fuqi.		Janë marr masat për vitet në vijim.	Progres pozitiv

2.	<p>Rekomandimi nr. 2</p> <p>Kryetari i Komisionit duhet të sigurojë se në rastet e shfrytëzimit të <u>Pushimit të lehonisë</u>, kompensimet të bëhen në harmoni të plotë me kërkesat ligjore dhe të sigurojë vendosjen e kontrolleve të shtuara për të parandaluar gabimet e identifikuar në mënyrë që rastet e tilla mos përsëriten.</p>	<p>KPM ka kërkuar sqarim nga MAP, me datë 20.11.2017, lidhur me formën e kompensimit të lehonave, mirëpo nuk ka pranuar ndonjë sqarim formal lidhur me këtë çështje. Meqenëse pagat llogariten nëpërmjet sistemit të payroll-it në kuadër të MAP-it, logjikisht KPM nuk ka qasje për ndërhyrje të ndalesës së shtesës të SHCK-së.</p> <p>Sipas KPM-së kishte qenë e drejtë që MAP-i të merret lidhur me kompensimet e lehonave.</p>	Janë marr masat për vitet në vijim.	Progres pozitiv
3.	<p>Rekomandimi nr. 3</p> <p>Kryetari i Komisionit duhet të sigurojë zhvillimin e procedurave të rekrutimit që këto <u>pozita të plotësohen me kontrata të rregullta</u>. Kohëzgjatja e funksionit si U.D. të mos jetë më e gjatë se periudha e përcaktuar ligjore.</p>	<p>Caktimi i Ushtruesit të Detyrës për pozitën e Zyrtarit të Lartë për Marrëdhënie me Publikun nga data 1 qershor 2017 deri më 28 shkurt 2018 kur Zyrtarja e Lartë për Marrëdhënie me Publikun është transferuar në pozitën e Zyrtares së Lartë për Monitorim Regjional në Departamentin për Monitorim dhe Analizë. Ka qenë domosdoshmëri që të caktohet dikush nga stafi për të siguruar që nuk ndërpritet komunikimi me media dhe me institucionet tjera dhe që faqja zyrtare e KPM-së menaxhohet nga stafi i brendshëm për të evituar çfarëdo problemi. Komunikimi me media është një ndër elementet më të rëndësishme në kryerjen e misionit të KPM-së së bashku edhe</p>	Janë marr masat për vitet në vijim.	Progres pozitiv

		me korrektësinë që duhet treguar në dhënën e përgjigjeve kundrejt kërkesave që vijnë nga publiku dhe të tjerë, dhe në pritje të aprovimit të pozitive të lira të punës nga MAP, kemi qenë të detyruar që këto detyra të mbulohen duke caktuar U.D. bazuar në Nenin 30 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.		
4.	<p>Rekomandimi nr. 4</p> <p>Kryetari i Komisionit duhet të sigurohen se nuk do të realizojnë pagesa para se të konfirmohet se Shërbimet e trajnimit janë kryer. Pagesave nga mallrat dhe shërbimet duhet ti paraprin një marrëveshje ku përcaktohen të drejtat dhe obligimet e palëve dhe të jenë në pajtim me ligjin e buxhetit dhe rregulloret në fuqi.</p>	<p>Në këtë rekomandim thuhet se pagesa për këtë trajnim nuk është në pajtim me ligjin e buxhetit nr. 05/L-25 i nenit 14 dhe neni 26 të rregullores nr. 01/2013. Sa për sqarim në nenin 14 pika 1 i referohet pagesave që kryhen përmes procedurave të prokurimit për mallra dhe shërbime dhe projekte kapitale dhe nuk i specifikon me theks të veçantë trajnimet e stafit. Ashtu siç është paraparë ligjin e prokurimit trajnimet janë të përjashtuara, konkretisht sqarohet në Nenin 3 përjashtimet, pika 6 e ligjit Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 thotë se: <i>Ky ligj nuk do të zbatohet për një kontratë të punësimit, nëse aktiviteti i tillë i prokurimit është lëndë e rregullave të tjera që vendosen me një ligj ose rregullore tjetër. Njëjtë, ligji aktual nuk do të aplikohet për kontratat në lidhje me trajnimet</i></p>	Janë marr masat për vitet në vijim.	Progres pozitiv

		<p><i>pasuniversitare apo trajnime profesionale nga punëdhënësit për zhvillimin e aftësive specifike të punëtorëve individualë. Për më shumë, ligji nuk do të aplikohet në prokurim ekskluzivisht të orientuar në përfaqësimin në formë të ofrimit të ushqimit dhe pijeve.</i></p> <p>Ndërsa edhe tek neni 26 i rregullores nr. 01/2013 konkretisht në pikën 2 specifikohen rastet që duhet përmbushur për tu kryer një pagesë ku parasheh kopjen e kontratës së nënshkruar nga zyrtari i prokurimit e që në këtë rast prapë i referohet procedurave të prokurimit që në rastin tonë ashtu siç u cek edhe më lart nuk është vepruar në bazë të ligjit të prokurimit pasi që në nenin 3 këtij ligji trajnimet janë përjashtuar.</p> <p>Sa i përket pagesës në avanc për trajnimin e paraparë është praktikë në të gjitha institucionet që duhet të bëhet fillimisht pagesa për tu bërë rezervimi i trajnimit, pagesat për rezervimet në konferenca ndërkombëtare etj, sidomos në rastet ku këto trajnime ofrohen nga kompani ndërkombëtare apo me te autorizuar te tyre. Po ashtu meqë trajnimet janë të përjashtuara nga prokurimi dhe avanset në përqindje ashtu siç janë të paraqitura më lartë bëhet fjalë vetëm për projekte kapitale si dhe kontrata të nënshkruara përmes procedurave të</p>	
--	--	--	--

		<p>prokurimit në këtë rast e vetmja rregullore që rregullon avancet dhe i lejon avancet, si ne rastin tonë pa procedura të prokurimit është rregullorja nr. 01/2013 konkretisht te neni 21, paragrafi 2, pika 2.3.</p> <p><i>2.3. Avancat për udhëtime;</i></p>		
5.	<p>Rekomandimi nr. 5</p> <p>Kryetari i Komisionit duhet të forcojnë kontrollet në <u>Menaxhimin e pasurisë</u>, duke formuar komisionin për vlerësim të pasurive në mënyrë që të bëjnë vlerësimin e drejtë dhe të plotë të të gjitha pasurive si dhe të konfirmojnë shkallën e tyre funksionale/të përdorimit. Rezultatet e raporteve përfundimtare duhet të shqyrtohen nga KPM dhe të pasohen me regjistrimet e nevojshme kontabël përputhje me kërkesat rregullative.</p>	<p>KPM-ja ka bërë menaxhimin e pasurive siq e parasheh : <u>Rregullorja për menaxhimin e pasurisë nr. 02/2013. Neni 6 si dhe rregullat e Thesarit.</u></p> <p>KPM-ja ka themeluar komisionin për inventarizim e pasurive dhe stoqeve, ku komisioni ka dal me raport lidhur me inventarizimin e pasurive dhe stoqeve siq e parasheh rregullorja për menaxhimin e pasurive nr 02/2013 Neni 19 pika 1,2,3,4,5,6 ku ky raport po ashtu ka reflektuar në Pasqyrat financiar vjetore për vitin 2017.</p> <p>Sa i përket themelimit të komisionit për vlerësimin e pasurive, KPM-ja nuk ka pasuri që janë jashtë përdorimit, në pritje të tjetërsimit (kërkesa për tjetërsim) si dhe pasuri të dëmtuara që është dashur të vlerësohen etj.</p> <p>Ashtu siq e parasheh rregullorja për menaxhimin e pasurisë Nr.02/2013 Neni 21 pika 4, Përgjegjësitë e Komisionit për Vlerësimin e Pasurisë jo Financiare janë:</p>	Janë marr masat për vitet në vijim.	Progres pozitiv

		<p>4.1. Vlerësimi i pasurive të dëmtuara;</p> <p>4.2. Vlerësimi i kërkesave për tjetërsim të pasurive;</p> <p>4.3. Prezantimi i dëshmimeve për vlerësimin e pasurisë;</p> <p>4.4. Përgatitja e raportit për pasurinë jo financiare që duhet të largohet nga përdorimi.</p> <p>KPM në mungesë të stafit si dhe për nga përbërja e një numri të vogël të stafit, nuk ka aplikuar sistemin E-pasuria për regjistrim të stoqeve. Vlera prej 409 euro e stoqeve e prezentuar në pasqyra është e bazuar në numërimin fizikë të tyre nga ana e Komisionit për Inventarizimin e pasurive dhe stoqeve. Janë marr masat për vitet në vijim të aplikohet sistemi E-pasuria për stoqe.</p>		
6.	<p>Rekomandimi nr. 6</p> <p>Kryetari i Komisionit <u>duhet të sigurohen aprovimin e strategjisë për transmetim digjital</u> në Republikën e Kosovës dhe analizim më të detajuar të rreziqeve me të cilat përballet KPM.</p>	<p>Në bazë të Ligjit Nr. 04/L-44, Neni 7 paragrafi 1, KPM është e ngarkuar me mandatin për të hartuar Strategjinë për kalim në transmetim digjital në Republikën e Kosovës si dhe dokumentet tjera strategjike për vlerësimet mediale audiovizual.</p> <p>Strategjia për digjitalizim definon në mënyrë gjithëpërfshirëse procesin e kalimit të transmetimit televiziv tokësor analog në transmetim tokësor digjital. Kjo strategji definon në mënyrë të qartë orientimet strategjike zhvillimore, obligimet dhe afatet kohore të kalimit të transmetimit tokësor analog në atë digjital, në pajtim të plotë me standardet e Unionit</p>	<p>Paragrafi 1.1, KPM është e ngarkuar me mandatin për të hartuar Strategjinë për kalim në transmetim digjital në Republikën e Kosovës si dhe dokumentet tjera strategjike për vlerësimet mediale audiovizual.</p> <p>Strategjia për digjitalizim definon në mënyrë gjithëpërfshirëse procesin e kalimit të transmetimit televiziv tokësor analog në transmetim tokësor digjital. Kjo strategji definon në mënyrë të qartë orientimet strategjike zhvillimore, obligimet dhe afatet kohore të kalimit të transmetimit tokësor analog në atë digjital, në pajtim të plotë me standardet e Unionit</p>	

		<p>Ndërkombëtar të Telekomunikacionit (ITU-së) dhe të Komisionit Evropian.</p> <p>Strategjia për kalim në transmetim digjital në Republikën e Kosovës është përgatitur nga KPM-ja dhe miratohet nga Qeveria, ashtu siç e parasheh Ligji për KPM-në.</p> <p>Kjo Strategji krijon kosto shtesë buxhetore për periudhën e implementimit të saj dhe kjo kosto nuk është pjesë e ndarjes buxhetore për vitin fiskal 2018 e as në projeksionet buxhetore për vitet 2019-2022.</p> <p>Strategjia është dërguar në Qeveri, mirpo nuk është aprovuar për shkak të koston së lartë.</p> <p>KPM e mirëpret nga Qeveria përkrahjen dhe miratimin e Strategjisë për kalim në transmetim digjital në Republikën e Kosovës.</p>		
--	--	--	--	--